



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 50 regjistër (JR)

Datë 30.10.2023

Nr. 84 i vendimit

Datë 17.11.2025

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 17.11.2025, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 50/2023 (JR), datë 30.10.2023, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 690, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pikat 2, 3 dhe 5 të Kushtetutës dhe nenet A, Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”; neni 6 e vijues i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe protokollet shtesë të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë; nenet 62, 63 e vijues, neni 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 690, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, iu është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive; (iii) ka mosdeklarime të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për papërshtatshmëri për vijimin e detyrës¹.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të

¹ Raporti nr. {***}, datë 21.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH nr. {***}, datë 14.10.2022, si dhe raporti nr. {***} prot., datë 11.10.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH nr. {***}, datë 25.10.2022

përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Vladimir Skënderi, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 690, datë 24.07.2023, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës [...].*

8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si dhe në vlerësimin tërësor si më poshtë:

➤ Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni vlerësoi se:

- *Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë, duke mos u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

- *Në rastin e subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.*

- *Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimi. Vladimir Skënderi nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

➤ Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni vlerësoi se:

Nga hetimi administrativ, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

➤ Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni vlerësoi se:

Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Janë konstatuar disa mangësi procedurale dhe ligjore të subjektit të rivlerësimit për çështje të ndjekura dhe trajtuara më sipër në këtë vendim, si dhe një rast për

grykim të çështjes në kushtet e konfliktit të interesit. Këto gjetje, trupi gjykues i ka mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor për subjektin e rivlerësimit Vladimir Skënderi.

▪ Në vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni ka konkluduar se mangësitë e evidentuara përgjatë procesit të lidhura me faktet konstatuese, janë si vijojnë:

*a) subjekti ka përdorur disa vite automjete të paregjistruara dhe me targa dhe dokumentacione të rreme dhe nuk ka paguar as detyrimet vjetore financiare pranë institucioneve shtetërore dhe, edhe pse është vënë në dijeni, nuk ka vepruar për t'i adresuar; b) subjekti ka bërë veprim fiktiv duke deklaruar kontratën nr. {***}/***, datë 26.12.2001, si kontratë dhurimi dhe jo kontratë shitjeje siç e deklaroi dhe vetë; c) mangësitë profesionale të trajtuara më sipër edhe me burim mediatik, sipas gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar; ç) gjykimi i një çështjeje në kushtet e konfliktit të interesit, në raport edhe me konstatimet e kriterit të pasurisë, çmohen nga trupi gjykues se duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata të cilat ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 dhe nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 690, datë 24.07.2023, duke e kundërshtuar atë në drejtim të procedurës së ndjekur nga ana e Komisionit, si dhe vlerësimit të kryer nga ky i fundit kryesisht për kriterin e pasurisë, por edhe atë etiko-profesional.

10. Subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi, ankimin e tij e shoqëroi me disa akte shkresore², për të cilat kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimin, të vendosë:

- *Shqyrtimin e ankimit në seancë gjyqësore në prani të palëve duke lejuar marrjen e provave të reja, në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, por edhe provave të tjera që nuk u pranuan nga Komisioni, me qëllim shqyrtimin e të gjitha pretendimeve të ngritura, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.*

² *Subjekti i ka bashkëlidhur ankimit aktet shkresore: (i) akt ekspertimi, datë 22.07.2023, kryer nga ekspert D. A. dhe M. L., së bashku me e-mail-in dhe kërkesën për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor; (ii) vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 26.07.2023, për prishjen e vendimit nr. {***}, datë 19.04.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe dërgimin e çështjes për rigjykim; (iii) vendim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***}, datë 26.07.2023, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së {***} kundër gjyqtarit Vladimir Skënderi; (iv) vendim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***}, datë 21.07.2023, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së shtetasit L. S.”; (v) vendim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 19.07.2023, “Mbi mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin e bërë nga avokati N. P., si dhe dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, datë 05.10.2023, për rrëzimin e kërkesës për anulimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal.*

- Në zbatim të nenit 53, pika "b" e ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar; ndryshimin e vendimit nr. 690, datë 24.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke vendosur konfirmimin tim në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Vladimir Skënderi, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit.

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 690, datë 24.07.2023, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

14. Pas regjistrimit në Kolegji të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit nr. 50/2023 (JR), datë 30.10.2023, që i përket ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi, ky i fundit, në mbështetje të ankimit, më datë 03.11.2025, ka paraqitur parashtrime me shkrim, si dhe ka depozituar disa akte³ shkresore për të cilat ka kërkuar marrjen e tyre si provë e re në gjykim.

³ (i) CV Vladimir Skënderi; (ii) listë mbi shkrimet e portaleve për komisionerët e Komisionit; (iii) certifikata për vërtetim pronësie, datë 13.03.2003, për pasurinë tokë arë 1159 m² në {***}, Tiranë; (iv) certifikata për vërtetim pronësie, datë 04.10.2013, për pasurinë tokë arë 559 m² në {***}, Tiranë; (v) certifikata për vërtetim pronësie, datë 03.10.2013, për pasurinë truall 600 m² në {***}, Tiranë; (vi) kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol.,

15. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit dhe parashkrimeve me shkrim, trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit për marrjen e tyre, pasi nga analiza e kryer në kuadër të parashkrimeve të nenit 47, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, në konsideratë edhe të parashkrimeve të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, u arrit në përfundimin se ato nuk plotësonin kërkesat e dispozitave procedurale të sipërcituara për pranueshmërinë e tyre si prova të reja në proces.
16. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, bazuar në dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë procesit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashkrimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashkrimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

17. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se, gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer një sërë shkeljesh procedurale në kundërshtim me garancitë e procesit të rregullt ligjor, të garantuara nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti parashtrroi pretendimet në vijim.
18. Subjekti pretendoi se Komisioni nuk ka pranuar kërkesën e tij nr. {***}, datë 06.07.2023, “Për pezullim të procedurës së rivlerësimit”, deri në shqyrtimin nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të çështjes me palë paditëse Dh. B. dhe të paditur {***}, kërkesë e cila, sipas tij, ishte në përputhje me parashkrimet e nenit 297, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile.
19. Sipas subjektit të rivlerësimit, pezullimi i procesit do t'i kishte shërbyer zgjidhjes më të drejtë të çështjes, pasi, ashtu siç kishte parashikuar ai, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 26.07.2023, ka prishur vendimin nr. {***}, datë 19.04.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (në vijim “Gjykata e Apelit”), vendim i cili kishte shërbyer si bazë për kërkesën e vëzhguesit ndërkombëtar për shkarkimin e tij nga detyra.
20. Subjekti pretendoi gjithashtu se Komisioni nuk i ka komunikuar vendimet e ndërmjetme të marra gjatë procesit të rivlerësimit, përfshirë vendimin nr. {***}, datë 12.07.2023, me të cilin është rrëzuar kërkesa për pezullim, duke i mohuar aksesin dhe të drejtën për ta kundërshtuar atë në Kolegji, në përputhje me nenin 67 të Kodit të Procedurave Administrative.

*datë 07.01.2007 dhe aktet për regjistrimin e pasurisë së dhuruar; (vii) kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.1996; (viii) procesverbal shkrim dore; (ix) ortofoto; (x) leje legalizimi godinë banimi 2 kate + papafigo + 1 kat nën tokë dhe planimetritë përkatëse; (xi) akt ekspertimi shtesë, datë 21.02.2023, i ing. B. O.; (xii) fletë formular, plotësuar me shkrim dore; (xiii) fletë artikulli nga gazeta “{***}”: “Skandali /krerët e policisë lëvizin me makina të vjedhura”; (xiv) kontratë shitjeje sendi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2007; (xv) fletë printim e-mail-i, datë 17.01.(pa vit) nga subjekti i rivlerësimit drejtuar info@ild.al; (xvi) kërkesë, datë 31.05.2023, e subjektit të rivlerësimit, drejtuar Komisionit për marrjen si provë të testit të poligrafit.*

21. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues konstaton fillimisht se më datë 06.07.2023⁴, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit kërkesë për pezullimin e procesit të rivlerësimit, duke argumentuar se, në kushtet kur ndaj vendimit nr. {***}, datë 19.04.2023, të Gjykatës së Apelit ishte ushtruar rekurs dhe çështja ishte regjistruar për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë, procesi i rivlerësimit duhej të pezullohej deri në marrjen e vendimit nga kjo gjykatë. Sipas subjektit, vendimi i ankimuar kishte shërbyer si një nga bazat e vlerësimit negativ të tij në rezultatet e hetimit administrativ.
22. Bashkëlidhur kësaj kërkesë, subjekti ka paraqitur *e-mail*-in e datës 05.07.2023, drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet të cilit kërkonte përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, duke shpjeguar edhe arsyet e urgjencës që lidheshin me procesin e rivlerësimit.
23. Rezulton se, me vendimin nr. {***}, datë 12.07.2023, Komisioni ka refuzuar kërkesën për pezullimin e procesit, duke e vlerësuar atë si të pabazuar në ligj. Në arsyetimin e këtij vendimi, është mbajtur qëndrimi se kërkesa synonte zvarritjen e procesit të rivlerësimit dhe nuk lidhej me mundësinë apo pamundësinë e subjektit për të dhënë shpjegime mbi gjetjet e Komisionit.
24. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e procesit, paraqitej e arsyeshme për t'u marrë në shqyrtim, për sa kohë një pjesë e konkluzioneve të Komisionit lidhej edhe me vendimin nr. {***}, datë 19.04.2023, të Gjykatës së Apelit, i cili ishte objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë.
25. Në këtë drejtim, Komisioni mund të kishte mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e nenit 470 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit ankimet ose rekursat e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme, shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga regjistrimi i tyre në gjykatën më të lartë.
26. Megjithatë, trupi gjykues vlerëson se refuzimi i kërkesës për pezullim, në vetvete, nuk përbën shkak për cenimin e procesit të rregullt ligjor. Kjo për arsye se vendimmarrja e Komisionit mbi themelin e çështjes i nënshtrohet kontrollit të plotë gjyqësor nga Kolegji, i cili vlerëson në mënyrë të pavarur bazueshmërinë e përfundimeve të Komisionit në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit.
27. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, pasi, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenet 8 e 11 të Kodit të Procedurës Civile, ka refuzuar pa arsyetim kërkesat e tij për marrjen e provave.
28. Konkretisht, subjekti pretendon se Komisioni nuk ka pranuar: kërkesën për kryerjen e testit të poligrafit; kërkesën nr. {***}, datë 07.06.2023, për marrjen e provave nga persona juridikë të huaj në lidhje me shpenzimet e udhëtimit; kërkesën nr. {***}, datë 07.06.2023, për marrjen e provave nga institucione shtetërore vendase në lidhje me dokumentacionin e automjetit; si dhe kërkesën nr. {***}, datë 07.06.2023, për marrjen e provës me ekspert autoteknik dhe/ose kryerjen e testit të poligrafit në lidhje me automjetin me targë {***}.
29. Subjekti pretendoi gjithashtu se të gjitha kërkesat e tij të përsëritura për marrjen e provave, janë refuzuar pa arsyetim. Sipas tij, në seancën e datës 24.07.2023, Komisioni nuk e lejoi të shprehej

⁴ Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 11.07.2023.

lidhur me kërkesën për riçelje të hetimit, të paraqitur me *e-mail* më datë 22.07.2023, duke refuzuar marrjen e aktit të ekspertimit të datës 22.07.2023, pa një vendim të arsyetuar dhe vetëm përmes një komunikimi verbal gjatë seancës.

30. Në lidhje me këto pretendime, trupi gjykues vëren se Komisioni ka trajtuar kërkesat procedurale të subjektit në përputhje me parashikimet e shkronjës “e”, pika 6 e “Hapave proceduralë të unifikuar”, miratuar me vendimin e Komisionit nr. {***}, datë 12.02.2018, të ndryshuar.
31. Nëpërmjet vendimeve nr. {***}, datë 12.07.2023 dhe nr. {***}, datë 18.07.2023, Komisioni ka vendosur refuzimin e këtyre kërkesave, duke arsyetuar se provat e kërkuara vlerësoheshin të panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
32. Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 20.07.2023, rezulton se, në faqen 2 të tij, kryesuesja e trupit gjykues ka relatuar mbi kërkesat procedurale të subjektit, vendimmarrjen e Komisionit dhe komunikimin e vendimeve përkatëse.
33. Nga i njëjti procesverbal, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur ndonjë pretendim në lidhje me trajtimin e kërkesave të tij apo me moskomunikimin e vendimeve të ndërmjetme.
34. Në faqen 25 të procesverbalit, subjekti është shprehur se: “Në lidhje me provat dhe veprimtarinë e Komisionit në tërësi, jam i kënaqur dhe kam vlerësim pozitiv. Komunikimi mes nesh ka qenë shumë i mirë, më janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet nga ana e tyre [...]”, pa evidentuar ndonjë shqetësim në lidhje me trajtimin e kërkesave procedurale apo komunikimin e vendimeve të ndërmjetme.
35. Adresimi i kërkesave procedurale të subjektit gjen pasqyrim, në mënyrë të përmbledhur, edhe në vendimin përfundimtar të Komisionit nr. 690, datë 24.07.2023, duke garantuar jo vetëm transparencën e procesit, por edhe mundësinë e subjektit të rivlerësimit për t’i kundërshtuar vendimet e ndërmjetme së bashku me vendimin përfundimtar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.
36. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton cenim të garancive procedurale që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor në asnjërin prej këtyre hapave proceduralë të ndjekur nga Komisioni. Për këto arsye, ky shkak ankimi vlerësohet i pabazuar.
37. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni, në seancën e datës 24.07.2023, ka refuzuar marrjen e provës akt ekspertimi dhe ka injoruar kërkesën e tij të datës 22.07.2023, të paraqitur nëpërmjet postës elektronike, për riçeljen e hetimit dhe administrimin e këtij akti, trupi gjykues vëren si vijon.
38. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se më datë 20.07.2023, është zhvilluar seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Vladimir Skënderi. Gjatë kësaj seance, subjekti paraqiti provat e depozituara prej tij dhe u ftua të paraqiste konkluzionet përfundimtare me shkrim. Në përfundim të seancës, kryesuesja e trupit gjykues deklaroi mbylljen e shqyrtimit të çështjes dhe tërheqjen e trupit gjykues në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit përfundimtar, i cili u caktua të shpallej më datë 24.07.2023.

39. Referuar akteve të dosjes së Komisionit, rezulton se më datë 21.07.2023, trupi gjykues është mbledhur për marrjen e vendimit në lidhje me subjektin e rivlerësimit. Më pas, më datë 22.07.2023, subjekti i rivlerësimit ka dërguar nëpërmjet postës elektronike, një kërkesë për riçeljen e hetimit me qëllim administrimin si provë të një akti ekspertimi kontabël, kërkesë të cilën ka deklaruar se do ta depozitonte edhe fizikisht në fillim të seancës së datës 24.07.2023, të caktuar për shpalljen e vendimit.
40. Referuar procesverbalit të seancës së datës 24.07.2023, Komisioni është shprehur se kjo ishte një seancë e shpalljes së vendimit dhe se mekanizmat proceduralë të parashikuar nga ligji për shqyrtimin e çështjes, ishin ezauruar, duke vijuar më tej me shpalljen e vendimit.
41. Në vlerësim të këtyre rrethanave, trupi gjykues konstaton se, në momentin e paraqitjes së kërkesës për riçeljen e hetimit, Komisioni kishte përfunduar shqyrtimin e çështjes dhe ishte tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar. Nga aktet, rezulton se diskutimet dhe vendimmarrja në lidhje me çështjen janë zhvilluar më datë 21.07.2023, në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar, ndërsa kërkesa e subjektit është paraqitur një ditë më pas, më datë 22.07.2023.
42. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ndodhej objektivisht në pamundësi për të shqyrtuar kërkesa procedurale të paraqitura pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes dhe pas marrjes së vendimit përfundimtar.
43. Edhe duke abstraguar nga ky moment procedural, trupi gjykues vëren se akti i ekspertimit kontabël i datës 22.07.2023, i përgatitur nga ekspertët D. A. dhe M. L., nuk rezulton të jetë paraqitur gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, ndonëse subjektit i ishte kaluar barra e provës që prej datës 29.06.2023, për të provuar ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve financiare për krijimin e pasurive dhe të ardhurave të deklaruara.
44. Megjithatë, subjekti zgjodhi të kërkonte administrimin e këtij akti vetëm pas seancës dëgjimore të datës 20.07.2023, pasi ishte vendosur mbyllja e shqyrtimit dhe trupi gjykues ishte tërhequr për marrjen e vendimit, pa parashtruar ndonjë arsye të vlefshme që të justifikonte pamundësinë për ta paraqitur këtë akt gjatë hetimit administrativ, me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit apo gjatë vetë seancës dëgjimore.
45. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave akti i ekspertimit i ishte dorëzuar nga ekspertët vetëm pas zhvillimit të seancës dëgjimore, vlerësohen jobindëse. Referuar vetë aktit të ekspertimit, rezulton se ai është kërkuar nga subjekti më datë 20.07.2023, pikërisht në ditën kur është zhvilluar seanca dëgjimore.
46. Po ashtu, nga procesverbali i kësaj seance, nuk rezulton që subjekti të ketë kërkuar kohë shtesë për përgatitjen ose marrjen në dorëzim të këtij akti ekspertimi. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mosparaqitja e kësaj analize financiare në Komision, ka qenë pasojë e zgjedhjes procedurale të vetë subjektit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet administrimi i saj si provë e re në këtë fazë të procesit.
47. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues çmon se ky akt ekspertimi mund të merret në konsideratë si pjesë e argumenteve dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në Kolegj.

48. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka analizuar dhe nuk ka marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij, konkretisht aktin e ekspertimit autoteknik të ekspertit, ing. N. H., aktin e ekspertimit të ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme B. O., aktin e ekspertimit të ekspertëve, ing. Gj. Ç. dhe agronom I. Gj., si dhe vendimin nr. {***}, datë 24.02.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar.
49. Nga aktet e administruara, rezulton se Komisioni ka referuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke i analizuar ato në raport me provat e tjera të administruara, përfundimet e nxjerra dhe arsyetimin mbi të cilin është mbështetur vendimi. Fakti që Komisioni ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga ai i mbrojtur nga subjekti, nuk do të thotë, në vetvete, se provat e paraqitura prej tij janë injoruar apo se është cenuar parimi i kontradiktoritetit.
50. Në kushtet kur nuk konstatohet ndonjë veprim procedural i kryer në kundërshtim me garancitë kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, ky shkak ankimi vlerësohet i pabazuar. Arsyetimi i trupit gjykues lidhur me peshën dhe vlerën provuese të secilës prej këtyre provave do të trajtohet në vijim, në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve materiale të ankimit.
51. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk e ka njohur me të gjitha provat dhe indiciet e administruara në dosje, duke cenuar të drejtat e tij procedurale. Sipas subjektit, atij nuk i janë vënë në dispozicion indiciet e mbërritura pranë Komisionit, të referuara në pikën 14, faqja 63 e vendimit objekt shqyrtimi, si dhe raporti i DSIK-së, i cili, sipas pretendimit të tij, nuk gjendet në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe i është përcjellë vetëm pas kërkesës së posaçme të paraqitur prej tij. Po ashtu, subjekti pretendon se në CD-në e marrë prej Komisionit, nuk gjendeshin të dhënat që lidhen me procedimin penal nr. {***}/2016, i përmendur në raportin e rezultateve të hetimit administrativ.
52. Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka zhvilluar një hetim të pavarur në kuadër të kontrollit të figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, duke verifikuar edhe informacionet e përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, me qëllim evidentimin e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose të përfshirjes së subjektit në veprimtari të kundërligjshme.
53. Bazuar në indiciet e mbërritura nga këto agjenci, Komisioni ka hetuar katër çështje gjyqësore në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit, të trajtuara në vendim në kreun “Të tjera”, duke administruar dosjet përkatëse të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Në raportin e rezultateve të hetimit administrativ, është bërë e ditur se një pjesë e gjetjeve të Komisionit mbështeteshin në të dhëna dhe indicie të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese.
54. Nga aktet e administruara, rezulton se, pas njohjes me raportin e rezultateve të hetimit administrativ dhe barrën e provës, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën për t'u njohur me materialet e dosjes së Komisionit, duke marrë dokumentacionin për të cilin kishte interes, si në formë elektronike, ashtu edhe në formë shkresore⁵. Në prapësimet e paraqitura ndaj

⁵ Në përmbajtje të deklaratës së nënshkruar prej subjektit në datën 30.06.2023, evidentohet si vijon: “[...] pasi u njoha me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, deklaroj se [...] nuk kam marrë dokumentet, por vetëm CD. Ju lutem më sillni dokumentet”. Në vijim,

rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka ngritur pretendime vetëm në lidhje me raportin e deklasifikuar të DSIK-së, pa evidentuar dokumente të tjera konkrete që pretendonte se nuk i ishin vënë në dispozicion.

55. Po ashtu, pa përsëritur sa është thënë në paragrafin nr. 34 të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se procesverbali i seancës dëgjimore dëshmon të kundërtën e pretendimit të subjektit të rivlerësimit.
56. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka marrë në dorëzim të gjitha aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, me përjashtim të dokumentacionit të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese, i cili mbrohet nga dispozitat e ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 46 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
57. Për rrjedhojë, në mungesë të pretendimeve konkrete dhe të provuara për mosvënien në dispozicion të akteve të caktuara, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit për cenimin e së drejtës së aksesit në provat e dosjes, është i pabazuar.
58. Lidhur me pretendimin e subjektit se procedura administrative e rivlerësimit ka tejkaluar afatin dymujor të parashikuar nga neni 91 i Kodit të Procedurave Administrative, në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk gjen mbështetje ligjore.
59. Neni 4, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se procesi i rivlerësimit fillon menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe se, kur çështja është gati për shqyrtim, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm. Nga kjo dispozitë, rezulton se ligji i posaçëm që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka parashikuar afate konkrete për përfundimin e procedurës administrative.
60. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk ka evidentuar ndonjë pasojë konkrete në ushtrimin e të drejtave të tij procedurale, si rezultat i kohëzgjatjes së procedurës administrative. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi vlerësohet i pabazuar.
61. I pabazuar u vlerësua edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit i është komunikuar përtej afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, në kundërshtim me parimet e një procesi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm.
62. Trupi gjykues vëren se, megjithëse komunikimi i vendimit nuk ka respektuar afatin e përcaktuar nga ligji, kjo vonesë nuk ka sjellë cenim të së drejtës së subjektit për akses efektiv në gjykatë, për sa kohë ai ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afatit ligjor dhe ankimi i tij është marrë në shqyrtim nga Kolegji në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.

bazuar në autorizimin me shkrim të subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi, në ambientet e Komisionit është paraqitur z. K. S., të cilit, sipas procesverbalit të datës 05.07.2023, i është vënë në dispozicion dokumentacioni fizik i hetimit administrativ sipas kërkesës së subjektit, gjithsej 1292 fletë, plus 3 CD.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë

➤ *Lidhur me pasurinë truall dhe ndërtim në {***}:*

63. Lidhur me shkakun e ankimit, me të cilin subjekti i rivlerësimit kundërshton si të padrejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë, deklarim të pamjaftueshëm dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë “truall dhe ndërtim në {***}”, trupi gjykues konstatoi si vijon.
64. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pas kontrollit të saktësisë së deklaramëve dhe verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
65. Ky konkluzion është mbështetur nga Komisioni në këto gjetje kryesore:
- subjekti ka bërë deklarime të pasakta lidhur me vlerën dhe periudhën e ndërtimit të objekteve;
 - subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës gjatë periudhës përkatëse, duke rezultuar, sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni, me një balancë negative në shumën (-) 12.915.688 lekë;
 - subjekti nuk arriti të provojë mundësinë financiare të huadhënësit, kunatit të tij P. K., për dhënie e huasë së pretenduar me burime të ligjshme financiare.
66. Në kundërshtim të këtyre përfundimeve, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzionet e Komisionit janë të pabazuara në fakt dhe në ligj, duke parashtruar argumente si në lidhje me kohën dhe vlerën e ndërtimit të objekteve, ashtu edhe në lidhje me burimet financiare që kanë shërbyer për krijimin e tyre.
67. Lidhur me vlerën dhe periudhën e investimit për këto objekte, subjekti ka pretenduar se:
- (i) vlera reale e ndërtimit është ajo e përlllogaritur në aktin e ekspertimit të datës 24.01.2017, e cila duhet të reduktohet me vlerën e punës së kryer prej tij dhe familjarëve, provuar sipas deklaratës noteriale nr. {***}/***, datë 14.07.2023, aktit të ekspertimit të ekspertit, ing. B. O., si dhe provave të tjera që, sipas tij, Komisioni ka refuzuar pa të drejtë t’i administrojë;
 - (ii) ortofotot përbëjnë provë shkencore për përcaktimin e kohës së ndërtimit, nga të cilat rezulton se objekti që më pas është shndërruar në serë, ekzistonte që në vitin 1999, ndërsa në fund të vitit 2002 kishin përfunduar dy katet e banesës, ndërsa gjatë periudhës 2003–2016 janë realizuar vetëm papafingoja dhe njësia e shërbimit;
 - (iii) përlllogaritja e kostove të ndërtimit sipas situacionit të përpiluar nga eksperti, është në përputhje me udhëzimin nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së dhe, nëse Komisioni kishte dyshime mbi këtë akt ekspertimi, duhej të caktonte ekspertë të tjerë;
 - (iv) referimi në kostot e Entit Kombëtar të Banesave, nuk është i drejtë, pasi ato kanë karakter orientues dhe nuk pasqyrojnë gjendjen konkrete të objektit, ndërsa përlllogaritjet e kryera nga

Komisioni janë të pasakta për shkak të periudhës së ndërtimit dhe karakteristikave të ndryshme të objekteve.

68. Në lidhje me burimet financiare që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare, duhet të përfshihen:
- (i) të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes që prej vitit 1983;
 - (ii) të ardhurat nga qiratë e njësisve të shërbimit në shumën 4.560.000 lekë;
 - (iii) të ardhurat nga toka dhe sera në shumën 8.572.088 lekë;
 - (iv) të ardhurat nga shitja e banesës në Bulqizë në vitin 1997, sipas deklaratës noteriale nr. {***}/{***}, datë 19.05.2023;
 - (v) të ardhurat nga dasmat e fëmijëve në shumën 3.167.160 lekë;
 - (vi) të ardhurat nga kursi i gjuhës angleze i vajzës së tij;
 - (vii) huaja prej 10.000 eurosh e marrë nga kunati i tij, z. P. K..
69. Sipas subjektit, përfshirja e këtyre të ardhurave në analizën financiare do të tregonte ekzistencën e burimeve të ligjshme dhe të mjaftueshme për krijimin e pasurisë dhe përballimin e shpenzimeve të kryera.
70. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, krahas kundërshtimit të konkluzioneve përfundimtare të Komisionit, ka riparashtruar edhe pretendime që lidhen me relatimin e deklarimeve të tij ndër vite, përshkrimin e situatës faktike dhe vlerësimin e kryer nga ILDKPKI-ja në raport me këtë pasuri, duke i trajtuar ato sipas renditjes së paragrafëve të vendimit objekt ankimi.
71. Nisur nga kjo mënyrë e strukturimit të ankimit, trupi gjykues do të analizojë në vijim vetëm ato pretendime që lidhen drejtpërdrejt me gjetjet mbi të cilat Komisioni ka mbështetur përgjegjësinë e subjektit dhe aplikimin e masës disiplinore, duke i vlerësuar ato në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor dhe arsyetimin e dhënë në vendimin e Komisionit.
- *Lidhur me kohën dhe vlerën e ndërtimit:*
72. Komisioni ka vlerësuar në vendim se u qëndron gjetjeve të pasqyruara në rezultatet e hetimit administrativ lidhur me kohën e ndërtimit të objekteve, duke u mbështetur në ortofotot për periudhat përkatëse. Bazuar në këto të dhëna, Komisioni ka arritur në përfundimin se gjatë periudhës së deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting* (1996–2000), nuk rezultojnë objekte të ndërtuara në truallin në pronësi të tij. Për rrjedhojë, ka vlerësuar se subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës në lidhje me vitet e ndërtimit të objekteve dhe, si pasojë, ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting*. Sa i përket vlerës së ndërtimit të objekteve, Komisioni ka çmuar se ajo duhet të përlllogaritet sipas kostove referuese të Entit Kombëtar të Banesave, duke mos pranuar pretendimin e subjektit për reduktimin e kostove për shkak të punës së kryer prej vetë tij dhe familjarëve.
73. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se pasaktësitë në deklaramet e tij lidhur me kohën e ndërtimit, kanë ardhur si pasojë e kalimit të një periudhe të gjatë kohore dhe nuk kanë sjellë pasoja konkrete, për sa kohë që koha e ndërtimit mund të përcaktohet në mënyrë objektive përmes ortofotove, të cilat, sipas tij, përbëjnë provë shkencore. Në këtë kuadër, subjekti ka pretenduar se ortofotoja e vitit 1999 provon ekzistencën e objektit që më vonë është shndërruar

në serë; ortofotoja e datës 16.02.2003 provon se deri në fund të vitit 2002, kishin përfunduar dy katet e banesës; gjatë periudhës 2003–2016, janë realizuar vetëm papafingoja dhe njësia e shërbimit; objekti 1+1, i mbuluar me çati llamarine, fillimisht ka shërbyer si banesë, më pas si ahur dhe në vijim është përshtatur si serë; viti i ndërtimit të karabinasë nuk përputhet domosdoshmërisht me vitin e përfundimit të plotë të objektit, pasi punimet e brendshme dhe ndarjet funksionale janë realizuar në vijimësi; ndërsa njësia e shërbimit është përfunduar në vitin 2007 dhe nuk është deklaruar për legalizim në vitin 2013, për shkak të ndryshimit të funksionit të saj. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se vlera reale e investimit është ajo e përcaktuar në aktin e ekspertimit të paraqitur prej tij.

74. Në vlerësim të këtyre pretendimeve, referuar akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton si vijon.
75. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: “Pasuria nr. {***}, z.k. {***}, truall me sip. 600 m² në {***}, mbi të cilin ndërtim për banim me sip. 103,9 m² dhe objekt për aktivitet me sip. 79,4 m², kryer në vitet 1996-2000 me kursimet nga paga etj., të ardhura të realizuara nga unë dhe bashkëshortja në vitet 1983-2000. Ndërtimi i kryer nga ne bashkëshortët me ndihmën e vëllezërve e të afërmve [...]”. Subjekti ka deklaruar gjithashtu vlerën e truallit dhe të objekteve, bazuar në raportin e vlerësimit të datës 24.01.2017.
76. Për të provuar vlerën e ndërtimit, subjekti ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës *vetting*, raportin e vlerësimit të përgatitur nga inxhinieri B. O. më datë 24.01.2017, në të cilin kostot e ndërtimit janë përlllogaritur në shumën 5.287.415 lekë për banesën dhe 2.893.980 lekë për njësinë e shërbimit, në total 8.181.395 lekë, bazuar në kostot e ndërtimit për periudhën 1996-2000.
77. Kjo pasuri rezulton të jetë deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2003, ku subjekti ka deklaruar: tokë bujqësore 1.000 m² në {***}; shtëpi banimi 100 m², e ndërtuar në vitet 1997-1999; si dhe lavazh për larje automjetesh, të ndërtuar në vitin 1998.
78. Në deklarimet periodike vjetore ndër vite, subjekti ka deklaruar:
- në DIPP-2004, ndërtimin e një ahuri dhe të një garazhi;
 - në DIPP-2005, ndërtimin e dy dhomave shtesë në banesë;
 - në DIPP-2006, ndarjen e një ambienti ekzistues dhe ndërtimin, mbi garazh, të një lokali ende të papërfunduar, financuar me një hua prej 10.000 eurosh nga kunati i tij P. K.;
 - në DIPP-të 2007-2008 nuk ka deklaruar ndryshime;
 - në DIPP-2009 ka deklaruar pajisjen me certifikatë pronësie për truallin në {***}.
79. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti⁶ ka deklaruar se kati i parë i banesës ishte ndërtuar në vitin 1998, përpara emërimit të tij si gjyqtar⁷, ndërsa kati i dytë dhe papafingoja janë ndërtuar gjatë periudhës 2000-2005. Sipas tij, vlera e të gjithë objektit arrinte rreth 6.000.000 lekë, ndërsa pjesa e ndërtuar pas emërimit si gjyqtar, kushtonte rreth 3.500.000 lekë. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se ambienti i shërbimit është ndërtuar në periudhën 2006-2008, me hua prej 10.000 eurosh nga kunati i tij.

⁶ Pyetja nr. 9 e pyetësorit nr. 2.

⁷ Data e emërimit në detyrë 01.10.1999.

80. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shprehur rezerva ndaj aktit të ekspertimit, duke pretenduar se eksperti nuk ka bërë vlerësim të veçantë për katin e parë; nuk janë marrë parasysh çmimet më të ulëta të materialeve në {***} në periudhën përkatëse; si dhe se punimet kryesore janë realizuar nga vetë ai dhe vëllezërit e tij, me angazhimin e specialistëve vetëm për procese të veçanta. Subjekti ka pretenduar se vlera reale e ndërtimit mbetet 8.181.395 lekë, sipas aktit të ekspertimit të datës 07.01.2007⁸, ndërsa në shtesën e datës 21.02.2023, është sqaruar se prej kësaj vlere duhet të zbritet edhe puna e krahut e kryer nga familjarët.
81. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja⁹, rezulton se më datë 01.11.2006, subjekti ka paraqitur formular vetëdeklarimi për legalizimin e objektit banesë, duke deklaruar se objekti kishte dy kate dhe çati me tjegulla, kufizohej me dyqan dhe garazh, ndërsa viti i ndërtimit të objektit ishte qershori i vitit 2000. Leja e legalizimit për godinën e banimit dhe godinën e shërbimit është lëshuar më datë 25.07.2013.
82. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar kohën, mënyrën dhe vlerën e ndërtimit të objekteve; vitet e ndërtimit dhe kostot e tyre; ekzistencën e mospërputhjeve ndërmjet deklarimeve të ndryshme; pretendimin se ortofotot nuk rrëzojnë deklaratimet e tij; ligjshmërinë e burimeve financiare; si dhe ekzistencën dhe mundësinë financiare të huadhënësit P. K..
83. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka ripërsëritur pretendimet e paraqitura edhe në ankim, duke theksuar se pjesa dërrmuese e pasurisë së paluajtshme ishte krijuar deri në fund të vitit 2002, fakt që, sipas tij, provohet nga ortofotoja e datës 16.02.2003.
84. Nga analiza krahasuese e deklarimeve të subjektit ndër vite, trupi gjykues konstaton se ato nuk paraqiten koherente në lidhje me kohën e fillimit dhe të përfundimit të objekteve. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting*, ndërtim gjatë viteve 1996-2000; në DIPP-të vjetore, ndërtimin e banesës gjatë viteve 1997-1999 dhe të lavazhit në vitin 1998; në pyetësorin standard, katin e parë në vitin 1998, katin e dytë dhe papafingon në vitet 2000-2005; në pyetësorin nr. 2, punime të shtrira deri në vitin 2015; ndërsa në formularin e legalizimit, ka deklaruar qershorin e vitit 2000 si vit ndërtimi të objektit banesë.
85. Në kushtet e këtyre deklarimeve të ndryshme dhe mungesës së dokumentacionit të kohës, Komisioni ka verifikuar të dhënat e publikuara nga ASIG dhe aplikacioni “Google Earth”¹⁰. Nga këto verifikime, rezulton se në ortofoton e vitit 1999 nuk identifikohen ndërtime në truallin e subjektit; në ortofotot e viteve 2002-2003, rezulton i ndërtuar vetëm kati i parë i banesës; në ortofoton e vitit 2004, rezulton e përfunduar godina e banimit me çati; ndërsa në ortofotot e vitit 2007, rezulton e përfunduar edhe godina e shërbimit.
86. Trupi gjykues vlerëson se, në mungesë të dokumentacionit provues të kohës dhe përballë deklarimeve kontradiktore të subjektit, ortofotot përbëjnë një element objektiv verifikimi, i cili

⁸ Duket se subjekti e ka cituar gabim datën e raportit sepse ky raport mban datën 24.01.2017.

⁹ Referuar formularit të pagesës së taksës së ndërtimit në infrastrukturë, cituar më lart, vlera e investimit rezulton të jetë 17.987.930 lekë për të dy objektet.

¹⁰ Të dhënat e përfituara nga imazhet satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm (në këtë rast, Google Earth), sipas nenit 3 të VKM-së nr. 588, datë 10.09.2014, konsiderohen si një nga metodat për verifikimin e ndërtimeve informale dhe ekuivalente me përdorimin e një harte.

mbështet përfundimin se godina e banimit është ndërtuar gjatë periudhës 2002-2004 dhe jo gjatë periudhës 1996-2000. Edhe nëse do të pranohej pretendimi se në vitin 1999 ekzistonte një objekt në truall, ai nuk mund të identifikohet me objektin dykatësh me papafingo që është objekt i këtij shqyrtimi.

87. Sa i takon godinës së shërbimit, nga ortofotoja e vitit 2004, nuk rezulton ekzistenca e saj. Në kushtet kur, për vitin 2006, mungojnë ortofoto të publikuara, trupi gjykues mbështetet në deklaratimet e vetë subjektit në formularin e legalizimit dhe në deklaratimet periodike. Nga këto deklarime, rezulton se garazhi është ndërtuar në vitin 2004, ndërsa ambienti i shërbimit është ngritur mbi të në vitin 2006 dhe rezulton i përfunduar në ortofoton e vitit 2007. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për një periudhë tjetër ndërtimi, vlerësohen deklarative dhe të pambështetura në prova bindëse.
88. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting* lidhur me vitet e ndërtimit të objekteve dhe nuk ka paraqitur prova bindëse për të provuar kohën dhe gjendjen e ndërtimit në secilën periudhë të deklaruar. Këto pasaktësi nuk mund të trajtohen si mospërputhje formale pa ndikim në procesin e rivlerësimit, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me analizën e burimeve financiare të përdorura për krijimin e pasurive në fjalë. Për këtë arsye, verifikimi i saktë i kohës së kryerjes së punimeve përbën një element thelbësor për vlerësimin e mëtejshëm të mjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme të subjektit për krijimin e këtyre pasurive.
89. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat ai kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerën e ndërtimit të objekteve, duke konstatuar si vijon.
90. Komisioni, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues të kohës së ndërtimit të objekteve, si: leje ndërtimi, situacione punimesh, preventivë apo fatura përkatëse, kreu vlerësimin e kostos së ndërtimit sipas praktikës së ndjekur për objektet e ndërtuara pa leje, duke iu referuar kostove të ndërtimit të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe të përlllogaritura nga Enti Kombëtar i Banesave.
91. Bazuar në këtë metodologji, Komisioni përcaktoi se kostoja totale e ndërtimit të objekteve për periudhën 2002–2006, ishte në shumën 13.968.189 lekë, e shpërndarë për efekt të analizës financiare si vijon: 2.325.542 lekë për katin e parë të banesës në vitet 2002–2003; 5.691.029 lekë për katin e dytë dhe papafingon në vitin 2004; 1.941.012 lekë për garazhin në vitin 2004; dhe 4.011.606 lekë për lokalin dykatësh në vitin 2006.
92. Në përfundim, Komisioni nuk mori në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me një vlerë të ndryshme ndërtimi dhe mbajti si bazë të analizës financiare, vlerën e investimit të përcaktuar në rezultatet e hetimit administrativ.
93. Në kundërshtim të këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se vlera reale e investimit është ajo e përlllogaritur në raportin e vlerësimit të datës 24.01.2017, të përgatitur nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme, ing. B. O., nga e cila duhet të zbritet edhe puna e krahut e kryer prej tij dhe familjarëve, sipas deklaratës noteriale nr. {***/{***}}, datë 14.07.2023.

94. Sipas subjektit, referimi te kostot e Entit Kombëtar të Banesave, nuk është i drejtë në kushtet kur ekziston një akt ekspertimi i kryer mbi bazën e verifikimeve konkrete në terren. Ai pretendoi se çmimet e EKB-së kanë karakter orientues dhe se gjendja reale e objektit mund të përcaktohet vetëm nëpërmjet situacionit të hartuar nga eksperti, i cili ka verifikuar punimet e kryera.
95. Subjekti kundërshtoi gjithashtu përlllogaritjet e Komisionit, duke pretenduar se ato janë të pasakta për shkak të kohës së ndërtimit dhe karakteristikave të objekteve. Sipas tij, ortofotoja e datës 16.02.2003 provon se dy katet e banesës kishin përfunduar brenda vitit 2002 dhe, për rrjedhojë, edhe për katin e dytë duhej të aplikoheshin kostot e vitit 2002, në masën 22.383 lekë/m² dhe jo 24.446 lekë/m². Po ashtu, ai pretendoi se papafingoja, e ndërtuar me gips, nuk mund të përlllogaritej me të njëjtën kosto si dy katet e para të ndërtuara me beton arme dhe mur tulle. Së fundi, subjekti argumentoi se kostot e ndërtimit në {***} nuk mund të barazohen me ato të zonave të tjera të vendit dhe se pasaktësitë në këtë drejtim, kanë ndikuar drejtpërdrejt në analizën financiare të kryer nga Komisioni.
96. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting* raportin e vlerësimit të datës 24.01.2017, të përgatitur nga eksperti, ing. B. O., sipas të cilit kostoja e ndërtimit të banesës përlllogaritet në shumën 5.287.415 lekë, ndërsa ajo e godinës së shërbimit në shumën 2.893.980 lekë.
97. Trupi gjykues vëren se përlllogaritjet e këtij raporti janë kryer mbi bazën e të dhënave dhe deklaratimeve të ofruara nga vetë subjekti i rivlerësimit, duke marrë si referencë periudhën 1996–2000 për kryerjen e investimit. Këto të dhëna bien në kundërshtim me gjetjet e konstatuara gjatë hetimit administrativ dhe me elementet objektive të verifikimit, konkretisht ortofotot e administruara nga ASIG dhe *Google Earth*, nga të cilat nuk rezulton ekzistenca e objekteve në periudhën e referuar në raportin e ekspertimit.
98. Po kështu, raporti i ekspertimit nuk shoqërohet me dokumentacion justifikues të kohës, si situacione punimesh, fatura tatimore apo dokumente të tjera që të mundësojnë verifikimin e pavarur të kostove të pretenduara. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ky raport nuk mund të konsiderohet provë me vlerë provuese për përcaktimin e kostos reale të ndërtimit të objekteve në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
99. Referuar jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit, në rastet kur subjektet e rivlerësimit nuk disponojnë dokumentacion justifikues për të provuar kostot e investimeve të kryera në objekte të ndërtuara prej tyre, vlera e këtyre investimeve përcaktohet mbi bazën e çmimeve për metër katror të miratuara nga Enti Kombëtar i Banesave, sipas viteve në të cilat është deklaruar ose rezulton të jetë kryer ndërtimi.
100. Pretendimet për zbritjen e kostos së punës së krahut, apo për aplikimin e kostove më të ulëta për shkak të karakterit informal të ndërtimit, u vlerësuan nga trupi gjykues të pabazuara në mungesë të provave konkrete që të dëshmojnë se secili komponent i veçantë i investimit është realizuar me kosto më të ulët sesa ajo e përcaktuar sipas metodologjisë së EKB-së.

101. Për rrjedhojë, kontrolli i mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të subjektit dhe të personave të lidhur me të, në mungesë të dokumentacionit justifikues për kostot e ndërtimit, duhet të mbështetet në të dhënat e EKB-së, si një metodë e arsyeshme dhe objektive. Në zbatim të këtij standardi, trupi gjykues vlerëson se kostoja e investimit në shumën 13.968.189 lekë, e përcaktuar nga Komisioni, duhet të merret si bazë për analizën financiare të mëtejshme.
102. Sa i takon pretendimit të subjektit se për katin e dytë të banesës, duhej të aplikoheshin kostot e ndërtimit të vitit 2002 dhe jo ato të vitit 2003, trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të pranohej ky pretendim, vlera totale e investimit do të rezultonte në shumën 13.679.473 lekë, pra me një diferencë prej 289.715 lekësh më të ulët krahasuar me përlllogaritjen e Komisionit.
103. Në raport me vlerën totale të investimit dhe rezultatin e analizës financiare, kjo diferencë nuk paraqet peshë përcaktuese dhe nuk është e tillë që të ndikojë në përfundimet e arritura nga Komisioni lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve financiare të subjektit.
104. Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit për gabime në analizën financiare të Komisionit, të lidhura me mosreflektimin e të gjitha burimeve financiare të pretenduara prej tij për krijimin e banesës dhe godinës së shërbimit, konkretisht: (i) të ardhurat nga shitja e banesës në Bulqizë; (ii) huanë prej 10.000 eurosh nga kunati i tij; (iii) të ardhurat nga kultivimi i tokës dhe prodhimet bujqësore; (iv) të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes që prej vitit 1983; si dhe (v) të ardhurat nga qiraja e lavazhit dhe më pas e godinës së shërbimit, duke konstatuar si vijon.
105. Komisioni ka konkluduar në vendim se, gjatë periudhës 1994-2006, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për ndërtimin e pasurive objekt shqyrtimi, duke rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 12.915.688 lekë.
106. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të përfituara nga shitja e banesës në Bulqizë, të cilat Komisioni nuk i ka konsideruar, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar.
107. Ashtu si Komisioni, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës në raport me ekzistencën dhe realizimin e kësaj shitjeje, për sa kohë nuk provoi, me dokumentacionin përkatës, regjistrimin e pasurisë në organin kompetent për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si dhe tjetërsimin e saj në favor të një personi të tretë. Në këtë drejtim, deklarata noteriale e paraqitur nga subjekti¹¹, në mungesë të dokumentacionit tjetër mbështetës, nuk mjafton për të provuar ekzistencën e të ardhurave të pretenduara nga kjo shitje dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare.
108. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare, duhet të përfshihet edhe huaja prej 10.000 eurosh, e marrë nga kunati i tij P. K. në vitin 2006, e provuar, sipas

¹¹ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., e datës 19.5.2023, në të cilën ai dhe shtetasi H. T. deklarojnë se subjekti i ka shitur këtij të fundit një banesë në vitin 1997, në çmimin 90.000 lekë.

subjektit, me deklaratën noteriale të huadhënësit, deklarin në DIPP-2006 dhe deklarimet e mëvonshme për shlyerjen e saj, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

109. Në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit për dhënien e huasë në shumën 10.000 euro, pasi nuk provoi me dokumentacion ligjor, aftësinë paguese të këtij të fundit. Në këtë drejtim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë krijimin e të ardhurave nga ana e huadhënësit, por është mjaftuar me deklarin se ai ka qenë emigrant në Itali.
110. Në kundërshtim të këtij përfundimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se huaja duhet të përfshihet në analizën financiare, pasi marrëdhënia e huadhënies provohet nga deklarata noteriale e huadhënësit, deklarimi i bërë në DIPP-2006, si dhe nga deklarimet e kryera ndër vite në lidhje me shlyerjen e saj.
111. Në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për shumën e dhënë hua, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ligjshmërinë e burimit të huasë së marrë nga kunati i tij.
112. Në këtë drejtim, vetë subjekti ka deklaruar se huadhënësi, gjatë viteve 2004–2005, ka qenë emigrant i parregullt në Itali, ku ka realizuar të ardhura nga punë të padeklaruara dhe se nuk disponon dokumentacion përkatës për provimin e tyre. Në këto kushte, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në pikën 21 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka provuar ligjshmërinë e burimit të shumës së dhënë hua dhe, për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të përfshihet në analizën financiare.
113. Sa i takon pretendimit të subjektit për refuzimin nga Komisioni të kërkesës për thirrjen e kunatit të tij në cilësinë e dëshmitarit, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i pabazuar.
114. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën me shkrim të kunatit të tij, në të cilën pasqyrohet ekzistenca e huasë dhe mënyra e shlyerjes së saj. Përveç kësaj deklarate, ai ka kërkuar që huadhënësi të pyetjet në cilësinë e dëshmitarit për të provuar marrëdhënien e huadhënies dhe krijimin e të ardhurave prej tij.
115. Megjithatë, në kushtet kur deklarata e huadhënësit ishte administruar tashmë si provë në dosje, deklarimet e tij të mundshme përpara Komisionit nuk do të ishin të afta të provonin ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të pretenduara, pasi vlera provuese e dëshmisë së tij do të ishte e njëjtë me atë të deklaratës së administruar. Për rrjedhojë, refuzimi i kësaj kërkesë nuk ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së subjektit të rivlerësimit.
116. Sa u takon të ardhurave nga kultivimi i tokës, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka vlerësuar në vendim se këto të ardhura të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të përfshihen si të ardhura më vete në analizën financiare, për shkak se janë të pamatshme dhe të pavërtetueshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

117. Megjithatë, duke marrë në konsideratë pretendimin e subjektit se familja e tij ka përfituar produkte bujqësore nga pemëtaria dhe sera, si dhe kërkesën për reduktimin e shpenzimeve ushqimore, Komisioni ka krijuar bindjen se puna bujqësore e familjes ka siguruar fruta dhe perime për konsum familjar. Për këtë arsye, ai ka reflektuar në analizën financiare një ulje të shpenzimeve të jetesës duke filluar nga viti 1998¹², vit në të cilin subjekti ka përfituar tokën bujqësore në {***}, Dibër, sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”.
118. Nga deklarata *vetting* dhe deklaratimet periodike ndër vite, rezulton se subjekti i rivlerësimit u është referuar prodhimeve bujqësore si të ardhura të realizuara, duke i konsideruar ato pjesë të burimeve financiare familjare. Megjithatë, gjatë hetimit administrativ dhe më pas në ankim, ai ka deklaruar se këto produkte nuk janë tregtuar, por janë përdorur vetëm për konsum familjar.
119. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka pranuar si të besueshme shpjegimet e subjektit në masën që këto prodhime kanë ndikuar në reduktimin e shpenzimeve të jetesës së familjes. Nga verifikimi i analizës financiare, rezulton se Komisioni ka marrë në konsideratë uljen e atyre shpenzimeve të jetesës që, në mënyrë të arsyeshme, mund të konsiderohen të përballuara nga kultivimet bujqësore të familjes, duke filluar nga viti 1998¹³.
120. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se këto të ardhura provohen me akt ekspertimi dhe me vendimin nr. {***}, datë 24.02.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është jorelevant në raport me vendimmarrjen e Komisionit. Për më tepër, vlerat e deklaruara si të ardhura nga kultivimi i tokës, nuk mund të përlllogariten si burim financiar më vete, për sa kohë vetë subjekti ka sqaruar se këto produkte nuk janë shitur, por janë konsumuar nga familja, me efekt të drejtpërdrejtë në uljen e shpenzimeve të jetesës.
121. Sa i takon pretendimit të subjektit se reduktimi i shpenzimeve të jetesës duhej të fillonte që nga viti 1991 kur, sipas tij, është bërë shpërndarja e tokave për fermerët në {***}, si dhe se toka në {***} është përfituar që në vitin 1996, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar.
122. AMTP-ja për përfitimin e tokës në {***}, Bulqizë, është lëshuar në vitin 1998 dhe, për këtë arsye, me të drejtë Komisioni ka filluar përlllogaritjen e reduktimit të shpenzimeve nga ky vit. Po kështu, referuar përgjigjeve të subjektit në pyetësorin standard lidhur me adresën e banimit,

¹² Bazuar në “Rezultatet e anketës së buxhetit të familjeve në Shqipëri, 2006 – 2007”, realizuar nga INSTAT-i, zbritja është bërë referuar përqindjes që zënë zërat e frutave dhe perimeve në totalin e konsumit mujor të një familjeje, të cilat zënë përkatësisht 14% dhe 8,8% të grupit të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike dhe në total zënë 22,8%, duke përbërë në vetvete 47,6% të konsumit total të një familjeje. Si rrjedhim, zbritja e shpenzimeve për grupin e fruta-perimeve, është përlllogaritur nga Komisioni në masën 10,8% ($22,8\% \times 47,6\% = 10,8\%$) të shpenzimeve të jetesës.

¹³ Anketa e Buxhetit të Familjes për vitet 2006–2007, e kryer nga INSTAT-i dhe e përdorur si referencë nga Komisioni, tregon se një familje shqiptare shpenzon mesatarisht rreth 69 mijë lekë në muaj, ose rreth 17 mijë lekë për frymë. Nga këto, 9 mijë lekë shkojnë për ushqim dhe pjesa tjetër prej 8 mijë lekësh për mallra e shërbime joushqimore. Në krahasim me anketën e viteve 1999–2000, konsumi për frymë është rritur 2,2 herë, ndërsa pas llogaritjes së inflacionit (23,2%), rritja reale rezulton rreth 1,8 herë. Struktura e shpenzimeve mbetet e ngjashme me vitin 2000, me ushqimin që zë peshën kryesore prej 47,6% të buxhetit familjar, i ndjekur nga banesa (7,4%), veshjet dhe këpucët (6,2%), transporti (6,2%) dhe kategori të tjera me peshë më të ulët. Brenda grupit ushqimor, perimet përfaqësojnë 14% dhe frutat 8,8%, pra së bashku 22,8% të ushqimit, që përlllogaritet rreth 10,8% e konsumit total.

rezulton se ai ka banuar në {***} në periudhën 01.09.1999 - 01.09.2000, pas fillimit të detyrës si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këto kushte, shfrytëzimi i tokës në {***} nuk mund të prezumohet se ka filluar përpara vitit 1998. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.

123. Lidhur me pretendimin e subjektit se të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes duhet të përlllogariten duke filluar nga viti 1983, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, ka arsyetuar se analiza financiare për subjektin e rivlerësimit fillon nga viti 1994, pavarësisht se të ardhurat e dokumentuara rezultojnë që nga viti 1991. Ky qëndrim është mbështetur në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës periudha përpara vitit 1993 është konsideruar si periudhë në të cilën aftësia për kursim ka qenë praktikisht e kufizuar, për shkak të zhvlerësimit të lekut dhe inflacionit të lartë. Për rrjedhojë, mosreflektimi i këtyre të ardhurave nuk rezulton të ketë ndikim domethënës në analizën financiare.
124. Në lidhje me sa më sipër, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën e tij¹⁴, trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave më të hershme, duke filluar që nga viti 1983, kjo do të duhej të shoqërohej domosdoshmërisht edhe me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë. Në këto kushte, nuk rezulton se përfshirja e këtyre të ardhurave do të sillte efekt pozitiv në analizën financiare, në mënyrën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të bazuar metodologjinë e ndjekur nga Komisioni për përlllogaritjen e të ardhurave për periudhën para vitit 1993.
125. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga qiraja e lavazhit për vitet 2004–2009 dhe, më pas, nga qiraja e godinës së shërbimit, trupi gjykues vëren se Komisioni ka vlerësuar në vendim se këto të ardhura nuk plotësojnë kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, nuk mund të kategorizohen si të ardhura të ligjshme e as të përfshihen në analizën financiare të subjektit.
126. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të këtij konkluzioni, ka pretenduar në ankim se të ardhurat nga qiraja e lavazhit dhe e njësisë së shërbimit duhet të përfshihen në analizën financiare si të ardhura të ligjshme, pasi ato provohen nga ortofotot që vërtetojnë ekzistencën e lavazhit, deklaratimet e tij në deklaratat periodike vjetore, deklaratat noteriale të qiramarrësit N. S., si dhe prova me dëshmitarë, marrja e së cilës është refuzuar nga Komisioni.
127. Në vlerësim të sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton si vijon. Në deklaratën *vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga qiraja e lavazhit në {***} për periudhën 2004-2009, në shumën 30.000 lekë në muaj, për një total prej 2.160.000 lekësh, si dhe të ardhura nga qiraja e godinës së shërbimit, për periudhën 2010-2013, në shumën 600.000 lekë në vit, për një total prej 2.400.000 lekësh. Ky deklaram nuk rezulton të jetë shoqëruar me dokumentacion shkresor provues.
128. Në deklaratimet periodike vjetore për vitet 2004-2009, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e lavazhit që administronte bashkëshortja, në shumën 360.000 lekë në vit. Ndërsa në DIPP-të

¹⁴ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 14, datë 09.07.2019.

e viteve 2010-2013, ai ka deklaruar të ardhura nga qiraja e lokalit që administronte bashkëshortja, në shumën 600.000 lekë në vit.

129. Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka sqaruar se: “Kam deklaruar në deklaratat periodike vjetore të ardhura nga lavazhi e, më pas, nga lokali që u ndërtua në vend të lavazhit, aktivitete këto që janë kryer nga bashkëshortja ime, sepse mua si gjyqtar më lejohej vetëm mësimdhënia. Për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja, jam në dijeni se nuk janë paguar tatimet as për të ardhurat e siguruara nga kultivimi i fruta-perimeve e as sa i përket qirasë mujore të marrë nga lavazhi e më pas nga lokali. Kjo ka ndodhur sepse nuk i është kërkuar që të paguajë taksa për frutat e perimet që kultivon. Po kështu, në kohën që merrte të ardhura nga qiraja e lavazhit dhe dyqanit, nuk ka pasur kontratë qiraje të shkruar dhe nuk i është kërkuar nga zyra tatimore që të paguajë tatime në një zonë informale sikurse ishte {***}. Prej tetë vitesh lokali është mbyllur dhe nuk ushtrohet aktivitet e nuk është vjelur qira”.
130. Lidhur me këtë situatë faktike, trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni, vlerëson se, pavarësisht se këto të ardhura janë deklaruar nga bashkëshortja e subjektit si në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në deklaratimet periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë ligjshmërinë e tyre në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti nuk paraqiti dokumentacion shkresor që të provojë se këto të ardhura janë deklaruar pranë organit kompetent tatimor¹⁵, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi të ardhurat¹⁶.
131. Po ashtu, në mungesë të dokumentacionit kontraktor¹⁷ që të provojë ekzistencën e marrëdhënies së qirasë dhe përcaktimin e përgjegjësisë për pagesën e detyrimeve tatimore, pretendimi i subjektit se këto detyrime i janë ngarkuar qiramarrësit, mbetet deklarativ. Nga ana tjetër, ndonëse subjekti ka pretenduar se aktiviteti i lavazhit është ushtruar nga vëllai i tij, ai nuk arriti të provojë se qiramarrësi ka ushtruar aktivitet tregtar me objekt lavazh dhe ka përmbushur detyrimet tatimore përkatëse, përfshirë edhe ato që lidhen me të ardhurat nga qiraja.
132. Në këto kushte, duke qenë përpara një aktiviteti të zhvilluar në informalitet të plotë, rrethanë e pranuar edhe nga vetë subjekti, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka provuar ligjshmërinë e burimit të këtyre të ardhurave. Për rrjedhojë, pretendimet e tij në këtë drejtim vlerësohen të pabazuara.
133. Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 1994–2006, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive gjatë kësaj periudhe, duke u konfirmuar balanca negative në shumën (-) 12.915.688 lekë.

¹⁵ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë (s’ka), protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 15.07.2022, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram vetëm për të ardhurat personale për periudhën 2019-2021.

¹⁶ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar ka parashikuar të ardhurat që u nënshtrohen detyrimeve tatimore, ku përfshihen: “[...] gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiteoza; si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit”.

¹⁷ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale të qiramarrësit, vëllait të tij, i cili ka pranuar se ai ka pasur detyrimin që të paguajë detyrimet ujë, drita, si dhe detyrimet tatimore.

134. Edhe nëse do të pranoheshin pretendimet e subjektit lidhur me: (i) përlogaritjen e kostos së ndërtimit sipas vlerave të EKB-së për vitin 2002; (ii) përfshirjen e të ardhurave që nga viti 1991 në shumën 36.157 lekë; (iii) aplikimin e reduktimit të shpenzimeve të jetesës për periudhën 1991-1997, për shkak të kultivimit të tokës në Dibër; (iv) uljen me 17% të kostos së ndërtimit për shkak të punës së krahut; si dhe (v) pretendimin se deri në vitin 2002 ishin ndërtuar dy kate të banesës, analiza financiare për periudhën 1994-2006 do të vijonte të rezultonte me balancë negative në shumën (-) 10.775.324 lekë.
135. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të saktësisë së deklaramit dhe verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, trupi gjykues vlerëson se, lidhur me pasurinë e paluajtshme “shtëpi banimi dykatëshe + papafingo dhe godinë shërbimi dy kate dhe një kat nëntokë”, të ndodhur në {***}, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pasaktë dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për ndërtimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
- *Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, tip “Renault”:*
136. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie, duke pretenduar se nuk është dakord me analizën financiare të kryer nga Komisioni, pasi ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e saj. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kursimet nga paga, të ardhurat nga qiraja e lavazhit dhe e lokalit, të ardhurat nga kultivimi i tokës, si dhe gjendjen *cash* të deklaruar në DIPP-2010, në shumën 1.200.000 lekë.
137. Në vlerësimin përfundimtar lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimin e krijimit të automjetit të blerë në vitin 2011, si dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e tij, duke rezultuar me balancë negative në shumën (-) 706.354 lekë.
138. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, referuar akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton si vijon.
139. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar autoveturën me targë {***}, marka “Renault”, modeli “Fluence”, nr. shasie {***}, të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, më datë 13.04.2011, kundrejt vlerës 15.000 euro. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë nga Alpha Bank dhe kursimet e tij. Në DIPP-2011, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit, kredinë bankare nga Alpha Bank.
140. Automjeti është blerë sipas marrëveshjes së shitblerjes të nënshkruar më datë 13.04.2011¹⁸, ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe subjektit, në cilësinë e blerësit, kundrejt çmimit 15.000 euro. Më datë 20.04.2011, subjekti ka nënshkruar kontratën e huasë me Alpha Bank¹⁹, për financimin e shumës 10.500 euro, me qëllim blerjen e automjetit tip “Renault Fluence”.

¹⁸ Dorëzuar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *vetting*.

¹⁹ Kontratë huaje nr. {***}, datë 20.04.2011, dorëzuar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *vetting*.

141. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar²⁰, rezulton se më datë 19.04.2011, subjekti ka depozituar *cash* shumën 5.000 euro në llogarinë e tij pranë Alpha Bank dhe, në të njëjtën datë, është transferuar shuma 4.500 euro në favor të palës shitëse, si pagesë për këstin e parë të blerjes së automjetit. Më datë 09.05.2011, është disbursuar kredia në shumën 10.500 euro, e cila është transferuar në favor të palës shitëse për blerjen e automjetit. Sipas të dhënave të DPSHTRR-së²¹, automjeti me targë {***}, figuron i regjistruar në pronësi të subjektit.
142. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të saktësonte dhe të provonte me dokumentacion justifikues ligjor burimin e shumës prej 4.500 eurosh, të përdorur si financim i pjesshëm për blerjen e automjetit. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se gjendja *cash* e deklaruar në DIPP-2010, në shumën 1.200.000 lekë, është përdorur për punime të brendshme në banesë, për shlyerjen e shumës 4.500 euro, për marrjen e vizës, si dhe për nevoja të tjera familjare. Si burim krijimi për këtë gjendje *cash*, subjekti ka deklaruar kursimet nga pagat, të ardhurat nga qiratë dhe të ardhurat nga kultivimi i tokës.
143. Bazuar në faktet e mësipërme, në lidhje me pretendimet e subjektit për kundërshtimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni për pagesën e shumës 4.500 euro më datë 19.04.2011, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikull dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit në raport me shkaqet e ankimit, vlerëson si vijon.
144. Pretendimi i subjektit se në analizën financiare duhet të përfshihet gjendja *cash* e deklaruar në DIPP-2010, në shumën 1.200.000 lekë, është i papabuar. Referuar DIPP-2010, rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në këtë shumë, me burim kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhura të tjera të familjes, përfshirë qiratë e viteve 2009 dhe 2010.
145. Nga kontrolli i ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit për vitin 2010, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 1.197.689 lekë, duke qenë në pamundësi financiare për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues, ashtu si Komisioni, vlerëson se kjo shumë nuk mund të konsiderohet burim i ligjshëm për blerjen e automjetit në vitin 2011.
146. Për më tepër, në DIPP-2011, vit në të cilin është krijuar pasuria objekt shqyrtimi, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit me kredi bankare nga Alpha Bank, në shumën 15.000 euro, më datë 23.04.2011, por nuk ka deklaruar pagesën e shumës 4.500 euro të kryer më datë 19.04.2011. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vitin 2011²², në funksion të krijimit të pasurisë automjet.
147. Lidhur me pretendimin se në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie, duhet të përfshihen të ardhurat nga qiratë dhe nga kultivimi i tokës, trupi gjykues vlerëson se, sa u takon të ardhurave nga qiraja e lavazhit për periudhën 2004-2009 dhe më pas nga qiraja e njësisë së shërbimit për vitet 2010-2013, siç është analizuar më sipër në këtë vendim, ato nuk mund të konsiderohen burime të ligjshme financiare. Ndërsa, sa u përket të ardhurave nga kultivimi i

²⁰ Shkresa kthim përgjigjeje e Bankës Alpha nr. {***} prot., datë 29.06.2022.

²¹ Shkresat e DPSHTRR-së nr. {***} prot., datë 17.07.2017 dhe datë 09.08.2017.

²² Në DIPP-2011, subjekti rezulton të ketë deklaruar se kursimet e tij janë depozituar përkohësisht në bankat Credins dhe Intesa San Paolo, 5000 USD dhe 3500 USD, llogari të cilat janë hapur dhe mbyllur brenda vitit 2011.

tokës, referuar analizës financiare përfundimtare të Komisionit lidhur me këtë pasuri, rezulton se ato janë reflektuar vetëm si zbritje në shpenzimet e jetesës²³.

148. Nga kontrolli i ushtruar ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues arrin në përfundimin se rezultati i saj konfirmohet. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 706.354 lekë për krijimin e shumës 4.500 euro/622.350 lekë, të paguar më datë 19.04.2011 për blerjen e automjetit.

149. Për rrjedhojë, lidhur me pasurinë automjet tip “Renault”, me targë {***}, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e shumës 4.500 euro më datë 19.04.2011, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ Në lidhje me deklaratimet e gjendjes *cash*:

150. Në përfundim të analizimit të gjendjes *cash*, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të pamjaftueshme gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj ndër vite. Në lidhje me mundësitë financiare për krijimin e kësaj gjendjeje dhe ndryshimet e saj ndër vite, Komisioni i është referuar analizës financiare të kryer për periudhën 2010-2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me balancë negative në vitet 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2015, përkatësisht në shumat (-) 1.197.689 lekë, (-) 3.044.107 lekë, (-) 17.002 lekë, (-) 7.089 lekë dhe (-) 1.990.111 lekë, siç është pasqyruar në pikën 13 të vendimit të Komisionit.

151. Referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit ndër vite, trupi gjykues konstaton si vijon.

152. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: “Kam gjendje *cash* në shtëpi 300.000 lekë”.

153. Në DIPP-2010, subjekti ka deklaruar: “Kursime nga pagat (imja dhe bashkëshortes) dhe të ardhura të tjera të familjes (qira etj.) të vitit 2009, 2010 – 1.200.000 lekë”. Në DIPP-2011 subjekti nuk ka deklaruar kursime jashtë sistemit bankar, por në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” ka deklaruar: “Shënim. Për efekt të marrjes së vizës amerikane për kursin njëmuor 1 - 30.06.2011, kam depozituar përkohësisht nga kursimet e mia në Credins dhe Intesa Sanpaolo: 5000\$ dhe 3500\$, llogari të cilat janë mbyllur gjatë vitit 2011”. Në DIPP-2012, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur shtesa të pasurive të paluajtshme, as ai dhe as familjarët e tij. Në DIPP-2013, subjekti ka deklaruar se nuk ka shtuar pasuritë gjatë vitit 2013. Në DIPP-2014, ka deklaruar se nuk ka shtuar apo pakësuar pasurinë gjatë vitit 2014. Në DIPP-2015, subjekti ka deklaruar: “Më 31.12.2015, kisha gjendje në shtëpi *cash*, të cilat i mbaj për çdo të papritur, sëmundje, fatkeqësi etj. – 300.000 lekë”. Të njëjtin deklaram ka kryer edhe në DIPP-2016.

154. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, me qëllim saktësimin e gjendjes *cash* dhe të likuiditeteve bankare për vitet 2009-2010, e ka pyetur subjektin në lidhje me gjendjen e likuiditeteve. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: “Në vitin 2009 dhe 2010 është pasqyruar gjendja e parave *cash* në shtëpi, në shumën 1.200.000 lekë, që përbëhet nga kursimet e pagës, qirasë së lavazhit e të lokalit dhe të ardhurave nga kultivimi i tokës etj. Kjo

²³ Paragrafi 4.18 i vendimit të Komisionit.

nuk do të thotë se gjendja *cash* në vitin 2008 ka qenë zero lekë, sepse çdo familje ndan para mënjane për ndonjë të papritur, por gjendja në vitin 2008 dhe në vitet kur nuk ka deklarim ka qenë nën një milion lekë dhe, për rrjedhojë, nuk ishte e detyrueshme për deklarim sipas legjislacionit në fuqi. Këto kursime janë përdorur pjesërisht për kryerjen e punimeve të brendshme (suvatime, instalime etj.) në banesën në {***}; për pagesën e shumës 4.500 euro në vitin 2011 për blerjen e automjetit “Renault” me targë {***}; për marrjen e vizës amerikane në vitin 2011, si dhe për nevoja të tjera personale dhe familjare”.

155. Subjekti i rivlerësimit është pyetur sërish nga Komisioni për të saktësuar deklaratimet e tij lidhur me shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash*. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ai ka deklaruar: “[...] Për t’ju përgjigjur pyetjes suaj, më duhet t’u referohem deklaratimeve vjetore periodike të pasurisë: në vitin 2010 është deklaruar *cash* në shumën 1.200.000 lekë (shih faqen 10 të deklaratës), ku pjesa ime takuese është shënuar 50%, për shkak të prezumimit të bashkëpronësisë me bashkëshorten. Burimi i krijimit është deklaruar si kursim nga paga ime dhe e bashkëshortes, si dhe nga të ardhurat nga qiraja etj., për vitet 2009 dhe 2010. Në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 nuk është deklaruar *cash*, pasi gjendja nuk duhet të ketë qenë mbi një milion lekë, shifër kjo e detyrueshme për deklarim; ndërsa në vitet 2015 dhe 2016, është deklaruar *cash* në shumën 300.000 lekë në secilin vit”.
156. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pasaktësitë në deklaratimet periodike kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve të formularëve të deklaratimit dhe paqartësive të krijuara prej tyre në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash*, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk gjen mbështetje në kuadrin ligjor dhe dokumentacionin përkatës të deklaratimit. Ligji nr. 9049/2003, në nenin 4 të tij, ka përcaktuar qartë objektin e deklarimit, duke parashikuar në pikën 1, shkronja “d”, detyrimin për deklarimin e likuiditeteve, gjendjes jashtë sistemit bankar, llogarive rrjedhëse, depozitave, bonove të thesarit dhe huadhënieve, në lekë ose në valutë të huaj. Nga ana tjetër, as formulari i deklarimit fillestar të vitit 2003 dhe as formularët e deklaratimeve periodike vjetore nuk përmbajnë kufizime apo udhëzime të tilla që të justifikojnë pretendimin e subjektit për ekzistencën e një konfuzioni objektiv në lidhje me detyrimin dhe mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash*. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pasaktësitë e konstatuara në deklarime nuk mund t’u atribuohen paqartësive të formularëve të deklarimit.
157. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në vitin 2003, ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 900.000 lekë dhe se kjo shumë padrejtësisht nuk është përfshirë në analizën financiare të Komisionit, trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk mbështetet në aktet e administruara. Nga shqyrtimi i deklaratës fillestare dhe i deklaratave periodike të pasurisë për periudhën 2003-2009, nuk rezulton të jetë deklaruar një gjendje e tillë *cash*. Këto deklarime, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë prova të përdorshme për verifikimin e gjendjes *cash* dhe ndryshimeve të saj ndër vite. Për më tepër, edhe nëse ky pretendim do të merrej i mirëqenë, ai nuk do të sillte përmirësim të rezultatit financiar të subjektit për vitin 2003. Përkundrazi, ekzistenca e një gjendjeje *cash* të ruajtur jashtë sistemit bankar presupozon mospërdorimin e saj për mbulimin e shpenzimeve apo krijimin e pasurive gjatë vitit përkatës, çka do të pakësonte fondet e disponueshme dhe do të ndikonte negativisht në rezultatit financiar. Për rrjedhojë, ky pretendim rezulton i pambështetur në prova dhe pa ndikim në favor të subjektit të rivlerësimit.

158. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar në ankim pretendime konkrete në lidhje me përlllogaritjen e mungesave financiare të konstatuara nga Komisioni për krijimin dhe ndryshimet e gjendjes *cash* ndër vite. Megjithatë, vlerësimi i burimeve financiare për krijimin dhe evoluimin e kësaj gjendjeje do të reflektohet në analizën financiare të përgjithshme për periudhën 2003-2016.
159. Në lidhje me të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka përsëritur të njëjtat pretendime të paraqitura edhe në pjesët e tjera të ankimit. Këto pretendime janë shqyrtuar tashmë në kuadër të analizës së burimeve financiare për pasurinë “shtëpi banimi dhe godinë shërbimi”. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk gjen shkak të rikthehet në shqyrtimin e tyre dhe konsideron të konfirmuara konkluzionet e Komisionit të pasqyruara në pikën 6 të vendimit objekt shqyrtimi.
160. Edhe sa u takon të ardhurave nga qiraja e lavazhit dhe, më pas, të godinës së shërbimit, subjekti i rivlerësimit ka përsëritur pretendimin se këto të ardhura duhej të përfshiheshin në analizën financiare si të ardhura të deklaruara dhe të provuara. Komisioni ka vlerësuar se këto të ardhura nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për shkak se nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen burime të ligjshme financiare. Për të njëjtat arsye të parashtuara në trajtimin e shkaqeve të ankimit, lidhur me burimet financiare të pasurisë “shtëpi banimi dhe godinë shërbimi”, trupi gjykues nuk gjen shkak të devijojë nga ky konkluzion, duke e konsideruar të konfirmuar qëndrimin e Komisionit të pasqyruar në pikën 7 të vendimit objekt shqyrtimi.
161. Sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me deklaratimet e vajzës së tij E. S., si dhe të djalit E. S., trupi gjykues konstaton se, ndonëse Komisioni i ka analizuar këto deklarime në vendim, në përfundim nuk e ka ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi në lidhje me to. Për rrjedhojë, këto pretendime nuk ndikojnë në konkluzionin përfundimtar të arritur nga Komisioni dhe nuk kërkojnë trajtim të mëtejshëm nga Kolegji.

➤ *Lidhur me të ardhurat nga dasmat e fëmijëve:*

162. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga *darovitjet* e përfituara në dasmat e fëmijëve të tij në vitet 2011 dhe 2015, trupi gjykues vëren si vijon.
163. Komisioni ka vlerësuar se nuk është provuar ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara nga dhurimet e bëra në dasmat e vajzës dhe djalit të subjektit në vitet 2011 dhe 2015 dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare. Konkretisht, Komisioni ka çmuar se nuk është provuar burimi i shumave 7.915 euro dhe 3.955 euro të depozituara nga subjekti në llogarinë e tij bankare, të cilat më pas kanë shërbyer për transferimin e shumës 12.000 euro në favor të vajzës së tij E. S., në datën 12.12.2011, duke mos u bindur se këto shuma përfaqësonin *darovitjet* e përfituara nga dasma e zhvilluar në muajin gusht të vitit 2011. Në kuadër të analizës financiare për vitet 2011 dhe 2015, Komisioni ka konsideruar si shpenzime shumën 500.000 lekë të deklaruar nga subjekti për organizimin e dasmës së vajzës dhe shumën 1.000.000 lekë të deklaruar për organizimin e dasmës së djalit. Po ashtu, janë përfshirë si dalje financiare edhe shumat 12.000 euro dhe 1.500.000 lekë, të deklaruara nga subjekti si vlera të

dhëna fëmijëve të tij, me arsyetimin se nuk është provuar ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara nga darovitjet e këtyre dasmave.

164. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë përfundim, duke pretenduar se ekzistojnë prova të mjaftueshme për krijimin e këtyre të ardhurave. Sipas tij, këtë e vërtetojnë aktet e ekspertimit kriminalistik të ekspertit Xh. Ç., të hartuara mbi bazën e filmimeve të dy dasmave, ku evidentohen momentet e *darovitjeve* të kryera nga të ftuarit për çiftet, dokumentacioni bankar që pasqyron depozitimin e shumave përkatëse, si dhe deklaratimet periodike të pasurisë, në të cilat këto të ardhura janë deklaruar në vitet 2011 dhe 2015, përpara fillimit të procesit të rivlerësimit. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se është kontradiktor vlerësimi i Komisionit që të mos njohë këto të ardhura, ndërkohë që ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet për organizimin e dasmave, duke u mbështetur vetëm në deklaratimet e tij.
165. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi dhe pas verifikimit të hetimit të kryer nga Komisioni, si dhe të akteve të administruara në fashikull, trupi gjykues konstaton si vijon.
166. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Të ardhura nga dhurata me vlerë nën 10.000 lekë secila, të mbledhura në dasmën e vajzës E. në vitin 2011, në shumën 12.000 euro”; si dhe: “Të ardhura nga dhurata me vlerë nën 10.000 lekë secila, të mbledhura në dasmën e djalit E. në vitin 2015, në shumën 1.500.000 lekë”.
167. Në DIPP-2011, subjekti ka deklaruar: “Dhurata me vlerë deri në 10.000 lekë secila nga dasma më datë 6.8.2011 e vajzës E., të cilat i kam depozituar në emrin e saj në Alpha Bank. Këto dhurata janë sjellë nga të afërm, miq e kolegë të mi, të bashkëshortes dhe të vajzës, ditën e dasmës dhe para saj, kur vinin për të na uruar, 12.000 euro”.
168. Në DIPP-2015, subjekti ka deklaruar: “Të ardhura nga dasma e djalit E., të krijuara nga darovitjet para dhe gjatë banketit, si dhe peshqeshet me vlerë nën 10.000 lekë, sjellë nga të afërm, shokë, miq e kolegë që vinin për urim, 1.500.000 lekë”. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar gjithashtu: “Kam kryer shpenzime për dasmën e djalit tim E., në vlerën 1.000.000 lekë”.
169. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se shumën 1.200.000 lekë, të mbledhur në dasmën e vajzës, ia ka dhënë asaj për nevoja shkollimi. Nga dokumentacioni bankar, rezulton se, gjatë vitit 2011, subjekti ka kryer këto veprime bankare në llogarinë e tij në monedhën euro pranë Alpha Bank: depozitimin e shumës 7.915 euro në datën 30.11.2011; depozitimin e shumës 3.955 euro në datën 12.12.2011; dhe transferimin e shumës 12.000 euro në favor të E. S., më datë 12.12.2011, me përshkrimin "për shkollim".
170. I pyetur në lidhje me burimin e këtyre shumave, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: “Sikurse kam shpjeguar edhe më parë, darovitjet dhe qokat nga dasma e vajzës së madhe E., në shumën 12.000 euro, ia kemi lënë asaj si pjesë e pajës. Këtë shumë parash e kam depozituar në Alpha Bank në dy këste, në shumat 7.915 euro dhe 3.955 euro. Rreth një javë më pas, kjo shumë prej 12.000 eurosh është kaluar në llogarinë e E., e cila, me sa jam në dijeni, e ka përdorur për qëllime shkollimi dhe nevoja të familjes së saj të re. Për të vendosur një lloj barazie mes fëmijëve, të njëjtën gjë bëmë edhe në rastin e E., në dasmën e të cilit shuma e përfituar ishte 1.500.000 lekë. Për të provuar këto të ardhura, ekspertit kriminalistik i janë vënë

në dispozicion disqet e filmimeve të dasmave dhe ai ka përpiluar aktet e ekspertimit teknik nr. {***}, datë 17.12.2021 dhe nr. {***}, datë 19.01.2022²⁴”.

171. Në lidhje me shpenzimet e kryera për organizimin e dasmave të fëmijëve, subjekti ka deklaruar se ato janë përballuar prej tij dhe bashkëshortes. Konkretisht, ai ka shpjeguar se: “Shpenzimet e banketit për dasmën e E., kanë qenë afërsisht në shumën 300.000 lekë. Shpenzimet e tjera nuk kanë kaluar shumën 200.000 lekë, pra në total kanë qenë më pak se 500.000 lekë. Nuk janë deklaruar në deklarinimin e vitit 2011, sepse deklarata e atij viti kërkonte deklarinimin vetëm të shpenzimeve me vlerë mbi 500.000 lekë”. Në DIPP-2015, subjekti ka deklaruar: “Kam kryer shpenzime për dasmën e djalit tim E.”, në vlerën 1.000.000 lekë.
172. Në vlerësim të sa më sipër, lidhur me aktet e ekspertimit të përgatitura nga eksperti kriminalist Xh. Ç. me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se ato nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për dokumentimin e vlerave konkrete të pretenduara si të përfituara nga dasmat e fëmijëve²⁵. Përfundimet e ekspertit kufizohen në evidentimin e momenteve filmike kur dasmorët kryejnë darovitje, pa qenë në gjendje të përcaktojnë shumën reale të të ardhurave të përfituara. Për rrjedhojë, këto akte nuk provojnë ekzistencën e të ardhurave në vlerat e deklaruara nga subjekti dhe nuk përmbushin standardin e kërkuar për provimin e ligjshmërisë së burimeve financiare. Në këto kushte, pretendimi i subjektit për përfitimin e shumave 12.000 euro dhe 1.500.000 lekë nga darovitjet e dasmorëve, mbetet i karakterit deklarativ dhe i pambështetur në prova të mjaftueshme.
173. Sa i takon pretendimit të subjektit se Komisioni ka vepruar në mënyrë kontradiktore duke mos njohur të ardhurat e pretenduara nga dasmat, ndërkohë që ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet për organizimin e tyre, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Vetë subjekti ka deklaruar, si në deklarinimet periodike, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, se shpenzimet e dasmave janë përballuar prej tij dhe bashkëshortes, pa pretenduar se ato janë kompensuar nga të ardhurat e përfituara nga darovitjet. Nga ana tjetër, referuar dokumentacionit bankar, shuma prej 12.000 eurosh rezulton të jetë transferuar në favor të vajzës së subjektit, znj. E. S., ndërsa për shumën 1.500.000 lekë, subjekti ka deklaruar se ia ka dhënë djalit të tij, z. E. S.²⁶. Në këto kushte, përfshirja në analizën financiare e shpenzimeve të deklaruara nga vetë subjekti për organizimin e dasmave, rezulton e drejtë dhe në përputhje me deklarinimet e tij.
174. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për trajtimin e shumave 12.000 euro dhe 1.500.000 lekë si shpenzime të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të

²⁴ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur dy akteksptime (për dy dasmat e fëmijëve), të cilat kanë të bëjnë me ekspertimin teknik të DVD-ve të pamjeve filmike të dy dasmave të fëmijëve. Nëpërmjet këtyre dy akteksptimeve të përgatitura nga eksperti kriminalist Xh. Ç., deklarohet se, nga regjistrimet video (foto të ekzaminuara), të ruajtura në kompakt disk, të dasmave të E. (2011) dhe E. (2015), janë konstatuar dhe evidentuar disa momente në të cilat vihen re dasmorë që hedhin kartëmonedha të prerjeve të ndryshme.

²⁵ Konkluzioni në këtë akt ekspertimi, është se: “nga video e ruajtur në kompakt diskun DVD objekt ekspertimi, me regjistrime të dasmës së E. S., u konstatuan dhe u evidentuan disa momente në të cilat vihen re dasmorë që dorovisin/hedhin kartëmonedha të prerjeve nga 1 deri 5 mijë lekë dhe nga 1 deri 10 dollarë disa prej të cilave janë paraqitur me foto në pjesën ekzaminuese.

²⁶ Në përgjigje të pyetjes 8 të pyetësorit nr. 2.

lidhur, për sa kohë vetë subjekti ka deklaruar se këto vlera u janë dhënë fëmijëve të tij. Për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen pjesë e likuiditeteve në dispozicion të familjes së subjektit. Në këto kushte, analiza financiare për vitet 2011 dhe 2015, mbetet e pandryshuar nga ajo e kryer prej Komisionit, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me balancë negative për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, në vlerat (-) 3.044.107 lekë dhe (-)1.990.111 lekë. Edhe nëse, në një qasje më favorizuese për subjektin, do të merreshin në konsideratë pretendimet e tij lidhur me të ardhurat e përfituara nga darovitjet e dasmorëve deri në masën e shpenzimeve të deklaruara për organizimin e dasmave, analiza financiare për vitet 2011 dhe 2015 do të vijonte sërish të rezultonte me balancë negative, ndonëse në vlera më të ulëta, përkatësisht (-)1.384.507 lekë dhe (-)490.111 lekë.

➤ *Gjetjet e tjera lidhur me dy automjete:*

175. Lidhur me shkakun e ankimit, me të cilin subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se ai ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasuritë automjet dhe ka vazhduar të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë veprimet e kryera, trupi gjykues vëren si vijon.
176. Në lidhje me këto automjete, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbysi barrën e provës dhe nuk dha shpjegime bindëse për arsyet që çuan në krijimin e kësaj situate konfuze në lidhje me dy automjetet e blera në vitet 2001 dhe 2002, të cilat ai i ka mbajtur pa dokumentacion dhe pa i regjistruar pranë DPSHTRR-së, si dhe pa kryer veprimet përkatëse, ndonëse kishte konstatuar problematika në lidhje me to. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasuritë automjet dhe ka vazhduar të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë veprimet e kryera, duke çmuar se këto veprime komprometojnë figurën e tij në cilësinë e gjyqtarit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në vlerësimin përfundimtar të tij.
177. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se automjetet me targë {***} dhe {***}, janë, në fakt, i njëjti automjet, i cili fillimisht ka mbajtur targën {***} dhe më pas targën {***}. Sipas tij, ky fakt është deklaruar prej tij që në kohën e plotësimit të deklaramit të pasurisë në vitin 2003 dhe vërtetohet edhe nga akti i ekspertimit të ekspertit, ing. N. H., i cili, pas krahasimit të fotografive të automjetit me targa të ndryshme, ka konkluduar se nuk ka pasur dy automjete, por vetëm një. Ky akt ekspertimi, sipas subjektit, është në harmoni edhe me deklaramtën noteriale të shtetasit B. S. dhe me shpjegimet e tij. Subjekti pretendon gjithashtu se Komisioni ka refuzuar kërkesat e tij për marrjen e provave pranë DPSHTRR-së, së cilës duhej t'i kërkoreshin të dhëna për automjetin/automjetet me targa {***} dhe {***}, në kushtet kur atij i ishte refuzuar dhënia e këtij informacioni. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka caktuar një ekspert autoteknik sipas nenit 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim sqarimin e faktit të ekzistencës së këtyre automjeteve dhe as nuk ka pranuar marrjen e dëshmisë së shtetasit B. S., i cili kishte shitur targat dhe dokumentet e automjetit me targë {***}.
178. Në kuadër të shqyrtimit të këtyre pretendimeve, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton si vijon.
179. Në DIPP-2003, subjekti ka deklaruar: “Autoveturë “Benz”, {***}, e regjistruar në emër të shitësit B. S., kontratë shitjeje materiale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.5.2002, 0,5

milion lekë, blerë në vitin 2002, në vlerën 100.000 lekë (ishte e dëmtuar dhe me rregullimet 400.000 lekë, vlera totale vajti 500.000 lekë)". Si burim krijimi, ka deklaruar kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

180. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se subjekti, në vitin 2001, kishte përfituar edhe një automjet me targë {***}, të cilin nuk e kishte deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003. I pyetur në lidhje me këtë rrethanë, subjekti deklaroi se: "Që në fillim theksoj se automjeti tip "Benz", me targë {***}, është i njëjti automjet që më parë kishte targën {***} [...]". Në vijim, ai shpjegoi mënyrën se si, sipas pretendimit të tij, kishte ndodhur ndryshimi i dokumentacionit dhe i targës së automjetit.
181. DPSHTRR-ja²⁷ nuk i ka konfirmuar këto dy automjete si pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi.
182. Nisur nga përgjigjja e subjektit dhe mungesa e informacionit për automjetin me targë {***}, Komisioni e ripyeti subjektin, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, deklaroi se: "DPSHTRR refuzoi të më japë informacion në lidhje me automjetin {***}, për shkak se ky automjet nuk figuronte në emrin tim [...] bashkëlidhur po ju nis dokumentacionin e plotë dhe origjinal të automjetit me targë {***}, me të cilin provoj se përderisa ky dokumentacion është tek unë, ai automjet nuk është shitur, por thjesht është pajisur me dokumente e targa të tjera {***} [...]. Duhet të mbahet në konsideratë informaliteti që ekzistonte 22 vite më parë në tregun e automjeteve [...], një prej tyre ishte edhe makina ime me targë {***}/ {***}"²⁸. Në mbështetje të pretendimit të tij se dy targat i përkisnin të njëjtit automjet dhe jo dy automjeteve të ndryshme, subjekti paraqiti edhe një akt ekspertimi autoteknik të përgatitur nga eksperti, ing. N. H.²⁹.
183. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-2003, automjetin me targë {***}, sipas kontratës së shitjes nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 10.05.2002, ndërkohë që nuk ka deklaruar automjetin e përfituar sipas kontratës nr. {***}/ {***}, datë 26.12.2001. Po ashtu, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse nëse ka ndjekur dhe zbatuar procedurat për regjistrimin pranë autoriteteve kompetente të

²⁷ Shiko përgjigjet e DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit dhe dosjen e ILDKPKI-së. Bazuar në përgjigjen me e-mail të DPSHTRR-së, datë 18.5.2023, dërguar subjektit të rivlerësimit, konstatohet se mjete me targë {***}, nuk është regjistruar asnjëherë në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

²⁸ Më datë 22.6.2023, subjekti ka paraqitur prova shtesë për pyetësorin nr. 4, si vijojnë: deklaratë noteriale²⁸, datë 16.6.2023, e shtetasit B. S., i cili deklaron se nuk kujtohet se ka pasur ndonjë automjet me targë {***}, por që është kujtuar pas konsultimit me shoferët që ka pasur. "Mbjaj mend që në vitin 2002, më ka ardhur një pronar servisi nga Vlora, i cili më shpjegoi se ka në servis in e tij një benz të cilit po i kryen disa shërbime, por është pa dokumente të rregullta. Pronari i servisit kish marrë dijeni se dokumentet e rregullta të benzit që kishte në servis, ndodheshin në magazinën e biznesit tim. Ai kërkoi t'i blinte dokumentet dhe targat e automjetit {***}, dhe unë mbaj mend që ia kam shitur në vlerën 100.000 lekë. Nuk mbaj mend nëse kam bërë ndonjë kontratë për këtë shitje të dokumenteve dhe të targave apo jo".

²⁹ Akt ekspertimi autoteknik, dërguar me provat shtesë për pyetësorin nr. 4, më datë 22.6.2023.

automjetit të përfituar prej tij në vitin 2001, me targë {***}³⁰, si dhe nuk ka provuar mënyrën se si, sipas pretendimit të tij, këtij automjeti iu ndryshua targa nga {***} në {***}.

184. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe atij të paraqitur nga vetë subjekti, nuk rezulton të jetë regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit ndonjë automjet me targë {***} apo {***}. Gjithashtu, automjeti me targë {***}, i shitur nga subjekti në vitin 2007 nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2007 (tipi “Benz 124”, shasia {***}, viti i prodhimit 1991), nuk paraqet të njëjtat të dhëna identifikuese me automjetin e përfituar sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2001 (tipi “200 D”, shasia {***}, viti i prodhimit 1992), ndërkohë që mungon kontrata nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 10.05.2002, e deklaruar nga subjekti në DIPP-2003. Po ashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në përgjigjen drejtuar subjektit me *e-mail*-in e datës 18.05.2023, ka bërë me dije se automjeti me targë {***}, nuk ka qenë dhe nuk është regjistruar ndonjëherë në emrin e tij.
185. Sa më sipër konstatuar, rezulton se automjeti i deklaruar në DIPP-2003, është mbajtur dhe përdorur nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë disavjeçare, gjatë së cilës nuk provohet të ketë qenë i regjistruar në emrin e tij dhe as të ketë qenë i pajisur me dokumentacion të rregullt qarkullimi.
186. Në këto kushte, edhe duke abstraguuar nga fakti nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë pronar i një apo dy automjeteve, për shkak se aktet e administruara nuk lejojnë arritjen në një përfundim të qartë mbi këtë rrethanë, trupi gjykues vlerëson se rezulton e provuar se ai ka pasur në përdorim të paktën një automjet që nuk rezulton të ketë qenë i regjistruar në emrin e tij dhe për të cilin nuk provohet ekzistenca e dokumentacionit të rregullt të qarkullimit. Po ashtu, nga vetë shpjegimet e subjektit, rezulton se ai ka pasur dijeni për problematikat që lidhen me dokumentacionin e automjetit të përdorur prej tij, por ka vijuar përdorimin e tij pa ndërmarrë veprimet e nevojshme për regjistrimin në përputhje me kërkesat ligjore. Një sjellje e tillë ngre dyshime të arsyeshme mbi korrektësinë dhe besueshmërinë e deklarimeve të tij në kriterin e pasurisë.
187. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se problematikat e konstatuara në lidhje me pronësinë, regjistrimin dhe përdorimin e automjetit nuk arrijnë, në vetvete, peshën e nevojshme për t'u kualifikuar si cenim i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Megjithatë, këto rrethana, të vlerësuara në tërësinë e tyre, mbeten relevante për vlerësimin e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e po këtij ligji.

➤ *Lidhur me analizën financiare:*

³⁰ Sipas parashikimeve në nenin 93 të ligjit nr. 8378, datë 22.4.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit, në rast ndryshimi pronësie të mjeteve rrugore ose në rastin kur u jepen në përdorim të tjerëve apo kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, personi i interesuar, brenda 30 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, paraqitet pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera.

188. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit se, nga analiza financiare, rezulton një pamjaftueshmëri financiare totale në shumën (-)19.639.589 lekë për periudhën 1994-2016³¹. Sipas tij, në këtë analizë duhet të përfshihen të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga paga për periudhën 1983-1994, të ardhurat nga toka dhe sera në shumën 8.572.087 lekë, të ardhurat nga qiraja e lavazhit dhe e lokalit në shumën 4.560.000 lekë, të ardhurat nga kursi i anglishtes i zhvilluar nga vajza e tij, si dhe të ardhurat nga dasmat në shumën 3.167.160 lekë. Subjekti ka kundërshtuar gjithashtu disa elemente të analizës financiare, duke pretenduar pasaktësi në lidhje me vlerën e ndërtimeve, shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, përlllogaritjen e konsumit familjar dhe shpenzimet për fëmijët. Sipas tij, pas korrigjimit të këtyre zërave, analiza financiare do të rezultonte me një tepriçë financiare prej 671.129,5 lekësh, duke provuar se pasuria e tij justifikohet plotësisht me burime të ligjshme dhe të dokumentuara. Subjekti pretendon gjithashtu se, referuar tabelës në faqen 40 të vendimit të Komisionit, pasuria totale e tij dhe e familjes rezulton në vlerën 16.889.189 lekë dhe, për rrjedhojë, duke qenë se 50% e saj i përket bashkëshortes në bazë të prezumimit ligjor të bashkëpronësisë, pasuria neto e tij është 8.444.595 lekë, ndërkohë që të ardhurat e tij për periudhën 1994-2016 arrijnë në shumën 15.272.261 lekë.
189. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes për periudhën 1983-1994, të ardhurat nga kultivimi i tokës, të ardhurat nga qiraja e lavazhit dhe njësisë së shërbimit, të ardhurat nga dasmat e fëmijëve, si dhe kundërshtimet në lidhje me vlerën dhe kohën e ndërtimit të banesës në {***} dhe të njësisë së shërbimit, përkojnë me pretendimet e trajtuara tashmë në kuadër të analizës së burimeve financiare për pasuritë “shtëpi banimi dykatëshe + papafingo” dhe “godinë shërbimi dykatëshe me një kat nëntokë”. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk gjen shkak të rikthehet në shqyrtimin e secilit prej tyre dhe i konsideron të konfirmuara arsyetimet e dhëna më sipër.
190. Sa i takon pretendimit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga kurset e anglishtes të zhvilluara nga vajza e subjektit, për të cilat ai ka deklaruar në përgjigje të rezultateve të hetimit se: “Të ardhura kam siguruar edhe nga kursi i anglishtes që bënte E., vërtetuar kjo me këtë certifikatë të lëshuar në datën 22.6.2012”, trupi gjykues konstaton se subjekti, ndonëse ka pretenduar ekzistencën e këtyre të ardhurave, nuk ka dokumentuar ligjshmërinë e tyre në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke mos provuar pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse. Në këto kushte, certifikata e paraqitur nuk përbën provë të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën dhe ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara. Për rrjedhojë, me të drejtë, Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare.
191. Në lidhje me pretendimin e subjektit se përlllogaritja e shpenzimeve të udhëtimeve në shumën 2.064.541 lekë, është e pabazuar dhe se në të janë përfshirë edhe shpenzime të fëmijëve që nuk kanë qenë më pjesë e trungut familjar, trupi gjykues vëren se, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, rezulton se për vajzën E., shpenzimet janë llogaritur deri në vitin 2010, një vit përpara martesës së saj, ndërsa për djalin E., deri në korrik 2015, përpara martesës së tij në

³¹ Përlllogaritjet në analizën financiare janë bërë sipas metodologjisë së shpjeguar në f. 41-42 të vendimit.

shtator të po atij viti. Për të gjithë periudhën, përlogaritjet janë kryer në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, të Kolegjit, duke përjashtuar rastet e dokumentuara si udhëtime pune ose vizita pranë të afërmeve. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit vlerësohen të pabazuara dhe shpenzimet mbeten të pandryshuara.

192. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të Komisionit mbi bazën e shkaqeve të ankimit dhe dokumentacionit të administruar në dosje. Nga ky kontroll, rezultoi se analiza financiare mbetet e pandryshuar për të gjithë periudhën e verifikuar, sipas rezultateve të pasqyruara në tabelën në faqen 40 të vendimit të Komisionit, nga e cila konstatohet një pamjaftueshmëri financiare në shumën (-)19.639.589 lekë.

➤ *Lidhur me cenimin e besimit të publikut:*

193. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim, konkluzionin e Komisionit se, nga vlerësimi tërësor i çështjes, bazuar në gjetjet e konstatuara në kriterin e pasurisë dhe atë profesional, ai ndodhet edhe në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Sipas subjektit, mangësitë procedurale të evidentuara nga Komisioni në pikat 13.16, 14.2 dhe 14.4 të vendimit, si dhe gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, të trajtuara në pikën 15 të tij, të cilat janë mbajtur në konsideratë në kuadër të vlerësimit tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë një vlerësim të padrejtë dhe joproporcional.
194. Në vlerësimin tërësor të çështjes³², Komisioni ka çmuar se: “[...] gjykimi i një çështjeje në kushtet e konfliktit të interesit, në raport edhe me konstatimet e kriterit të pasurisë, përbën një situatë që ndikon në cenimin e besimit të publikut në kuptim të neneve 4, pika 2 dhe 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë për përmirësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Ky konkluzion është mbështetur në problematikat e evidentuara në paragrafët 11.15 dhe 11.16 të vendimit, që lidhen me përdorimin e automjeteve të paregjistruara, si dhe në mangësitë profesionale të konstatuara në çështjet F. D., F. Gj. dhe M. Xh., duke përfshirë edhe gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 07.06.2023”.
195. Në lidhje me denoncimin e adresuar në Komision nga shtetasi F. D.³³, Komisioni, pas analizimit të denoncimit dhe administrimit të dosjes gjyqësore³⁴, mori në shqyrtim çështjen për të cilën subjekti kishte dhënë vendimin nr. {***}, datë 07.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe arriti në përfundimin se ai kishte kryer shkelje procedurale gjatë gjykimit të saj. Sipas Komisionit, këto shkelje bien ndesh me nenin 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të aspektit profesional.
196. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke pretenduar se, me vendimin e dhënë prej tij, ka pranuar kërkesëpadinë dhe ka detyruar palën e paditur të njohë si ish-pronar të ndjerin I. D., përfaqësuar nga i biri, F., krahas trashëgimtarëve të tjerë. Sipas subjektit, mënyra e përcaktimit të ndërëgjyqësisë i takon paditësit dhe gjykata nuk kishte arsye të

³² Sipas pikës 16 të vendimit të Komisionit.

³³ Sqarim në lidhje me denoncuesin F. D.. Referuar denoncimit të paraqitur në Komision, si dhe vendimit nr. {***}, datë 7.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, mbiemri i tij është Gj..

³⁴ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 28.02.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

ndërhynte, pasi ajo ishte në përputhje me nenin 296 të Kodit Civil. Ai ka pretenduar gjithashtu se edhe gjyqtari M. K. ka arritur në të njëjtin përfundim në themel të çështjes.

197. Nga analiza e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka evidentuar drejt situatën faktike në lidhje me mosnjohimin dhe mosthirrjen në gjykim të trashëgimtarëve të tjerë të z. I. D.. Kjo rrethanë është konsideruar nga gjykata e apelit si shkak që e bën procesin të parregullt dhe, për rrjedhojë, me të drejtë është vlerësuar nga Komisioni si mangësi profesionale në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.
198. Në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 28.10.2020, me të pandehur shtetasin F. Gj., Komisioni, bazuar në indiciet e administruara në kuadër të kontrollit të figurës³⁵, administroi dhe analizoi vendimin përkatës të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit kishte treguar aftësi të dobëta profesionale në drejtim të interpretimit të ligjit dhe identifikimit të konfliktit të normave juridike, në aspektin e analizës dhe argumentimit logjik, në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.
199. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë përfundim, duke pretenduar se ka sqaruar Komisionin mbi arsyet e dhënies së vendimit nr. {***}, datë 28.10.2020. Sipas tij, në atë çështje nuk ekzistonin prova të mjaftueshme për të provuar fajësinë e të pandehurit F. Gj. dhe, për këtë arsye, ai kishte vendosur pushimin e çështjes në përputhje me nenin 328, pika 1, shkronja “ç”, dhe nenin 332, shkronja “dh” e Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se vendimi i pushimit ishte i revokueshëm dhe se, pas prishjes së tij nga gjykata e apelit, çështja u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues, i cili përfundimisht deklaroi të pafajshëm të pandehurin. Sipas subjektit, vlerësimi i fajësisë apo pafajësisë së F. Gj. është atribut i gjykatave më të larta dhe jo i Komisionit.
200. Referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ dhe arsyesimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se qëndrimi i Komisionit në lidhje me këtë çështje, paraqitet i paqartë. Nga njëra anë, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të dobëta profesionale në drejtim të interpretimit të ligjit dhe identifikimit të konfliktit të normave, situatë e cila kualifikohet sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016; nga ana tjetër, në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale, arrin në konkluzionin se subjekti ka arritur nivel kualifikues për këtë kriter.
201. Në lidhje me vendimin nr. {***}, datë 15.06.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me të pandehur shtetasin M. Xh., Komisioni arriti në përfundimin se mosrespektimi i afateve procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk përbënte justifikim në aspektin e detyrimit ligjor, por se ky fakt do të merrej në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të aftësive profesionale.

³⁵ Referuar paragrafëve 6 dhe 7 të vendimit, rezulton se Komisioni ka kryer një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese, me qëllim evidentimin e kontakteve të papërshtatshme apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme. Komisioni ka hetuar në lidhje me 4 çështje gjyqësore, për të cilat janë administruar dosjet përkatëse, trajtuar në rubrikën “Të tjera”. Në aktet në fashikullin e Komisionit, nuk evidentohet njohja me informacion të klasifikuar pranë agjencive ligjzbatuese.

202. Subjekti i rivlerësimit pretendon se data e marrjes formë të prerë të vendimit nuk përkon domosdoshmërisht me datën e arsytimit të tij, pasi duhet të merren në konsideratë koha e nevojshme për administrimin e dosjes nga sekretaria gjyqësore, postimin dhe komunikimin e vendimit palëve, si dhe afati 15-ditor që duhet të kalojë nga nënshkrimi i dëftesës së komunikimit.
203. Nga analiza e akteve të administruara, rezulton se situata e përshkruar nga Komisioni, kualifikohet sipas nënindikatoreve të parashikuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016. Megjithatë, edhe në këtë rast, qëndrimi i Komisionit paraqitet i paqartë, pasi, nga njëra anë, konkludon se kjo rrethanë duhet të merret në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të aftësive profesionale, ndërsa, nga ana tjetër, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në këtë kriter. Në vijim, të njëjtat mangësi profesionale mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor për të mbështetur konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.
204. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se problematikat e evidentuara në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, ndonëse përbëjnë mangësi që duhen mbajtur në konsideratë, nuk paraqesin peshë të atillë që të justifikojnë përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit në këtë drejtim, rezulton i pabazuar.
205. Trupi gjykues nuk zhvilloi hetim gjyqësor në lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti në ankim mbi konstatimet e Komisionit bazuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, lidhur me mënyrën e marrjes nga subjekti të vendimit nr. {***}, datë 24.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës³⁶, për sa kohë ato lidhen me themelin e çështjes ose me aspekte të tjera të procesit të rregullt ligjor dhe, si të tilla, do t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku ndodhen aktualisht në shqyrtim dhe, për pasojë, nuk mund të shërbejnë për vlerësimin tërësor të subjektit.
206. Trupi gjykues, pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe shqyrtoi provat e administruara gjatë hetimit administrativ, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, çmon se konkluzionet e arritura në lidhje me kontrollin e pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting*, janë, në vetvete, të mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe se, për këtë arsye, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
207. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 690, datë 24.07.2023, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, rezulton i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

³⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.06.2023, e ONM-së, pjesë e akteve në fashikullin e Komisionit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 690, datë 24.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 17.11.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi